




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

# UDHËZUES PRAKTIK MBI KRITERET E PRANUESHMËRISË: KËRKESAT INDIVIDUALE





Ky Udhëzues është zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Hartimi i tij është mbështetur gjithashtu përmes kontributit të Institutit të Kosovës për Drejtësi, nën angazhimin dhe mbështetjen financiare të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë. Të gjitha të drejtat autoriale i përkasin Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ky udhëzues do të përditësohet në baza të rregullta nga Gjykata Kushtetuese dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimeve redaksionale.

© **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2024.**

# PËRMBAJTJA

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>vi</b>
<b>I. HYRJE .....</b>	<b>1</b>
<b>II. BAZAT PROCEDURALE PËR PAPANUESHMËRI .....</b>	<b>4</b>
1. PALA E AUTORIZUAR .....	4
1.1 KATEGORITË E PALËVE TË AUTORIZUARA/PARASHTRUESVE TË KËRKESAVE .....	5
1.1.1 Personat Fizikë .....	5
1.1.2 Personat Juridikë .....	6
1.2 STATUSI I VIKTIMËS .....	7
1.2.1 Viktima direkte ose e drejtpërdrejtë .....	8
1.2.2 Viktima indirekte ose e tërthortë .....	9
1.2.3 Viktimat potenciale .....	11
1.2.4 Actio Popularis .....	11
1.2.5 Humbja e statusit të viktimës .....	11
1.3 PËRFAQËSIMI .....	12
1.4 TËRHEQJA E KËRKESAVE NGA PALËT .....	13
<b>III. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE .....</b>	<b>14</b>
1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E DETYRIMIT KUSHTETUES PËR SHTERIMIN E MJETEVE EFEKTIVE JURIDIKE .....	14
1.1 DETYRIMI I SHTERIMIT TË MJETEVE JURIDIKE NË KUPTIMIN FORMAL-PROCEDURAL .....	15
1.1.1 Lirimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike në kuptimin formal-procedural .....	17
1.1.2 Ekzistenca e disa mjeteve juridike dhe mjetet juridike në diskrecionin e një autoriteti tjetër .....	18
1.1.3 Kërkesat e parakohshme .....	18
1.2 DETYRIMI I SHTERIMIT TË MJETEVE JURIDIKE NË KUPTIMIN SUBSTANCIAL .....	19
<b>IV. AFATI KATËRMUJOR .....</b>	<b>20</b>
1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E AFATIT KATËR (4) MUJOR PËR PARASHTRIMIN E KËRKESAVE .....	20
1.1 VENDIMI PËRFUNDIMTAR .....	21
1.1.1 Fillimi dhe përfundimi i afatit katër (4) mujor .....	21
1.1.2 Kthimi në gjendjen e mëparshme .....	22
1.2 Mjeti i fundit efektiv juridik në lidhje me vendimin përfundimtar .....	23
1.2.1 Mjetet juridike të palejuara/joefektive .....	23
1.2.2 Mungesa e mjetit juridik efektiv në dispozicion të palës .....	24
1.2.3 Situata e shkeljeve të vazhdueshme .....	25
<b>V. MOSSAKTËSIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE NGA PARASHTRUESI I KËRKESËS .....</b>	<b>26</b>
<b>VI. PAPANUESHMËRIA E KËRKESËS BAZUAR NË MERITA – KËRKESA QARTAZI E PABAZUAR .....</b>	<b>27</b>
1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E SHPALLJES SË KËRKESAVE TË PAPANUESHME SI QARTAZI TË PABAZUARA NË BAZA KUSHTETUESE .....	27
1.1 Pretendimet e “shkallës së katërt” .....	28
1.2 Mungesa e dukshme ose evidente e shkeljes .....	29
1.3 Pretendimet e “pambështetura dhe paarsyetuara” .....	30
1.4 Pretendimet “konfuze ose të paqarta” .....	30

<b>VII. BAZAT E PAPANUESHMËRISË LIDHUR ME JURIDIKSIONIN E GJYKATËS.....</b>	<b>31</b>
1. PAPANUESHMËRIA <i>RATIONE MATERIAE</i> .....	31
1.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPANUESHMËRISË <i>RATIONE MATERIAE</i> ME KUSHTETUTËN .....	31
1.1.1 Rishikimi dhe ripërsëritja e procedurës .....	32
1.1.2 Procedurat paraprake.....	34
1.1.3 Akuza penale e ngritur ndaj personit të tretë .....	34
2. PAPANUESHMËRIA <i>RATIONE PERSONAE</i> .....	36
2.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPANUESHMËRISË <i>RATIONE PERSONAE</i> ME KUSHTETUTËN .....	36
3.PAPANUESHMËRIA <i>RATIONE TEMPORIS</i> .....	38
3.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPANUESHMËRISË <i>RATIONE TEMPORIS</i> ME KUSHTETUTËN.....	38
4.PAPANUESHMËRIA <i>RATIONE LOCI</i> .....	40
4.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPANUESHMËRISË <i>RATIONE LOCI</i> ME KUSHTETUTËN.....	40
<b>VIII. HEDHJA POSHTË DHE REFUZIMI I KËRKESËS.....</b>	<b>41</b>
1.RASTI NUK ËSHTË MË NË MËNYRË AKTIVE I DISKUTUESHËM.....	41
2.RASTI NUK PËRFAQËSON NJË KONTEST .....	42
3.KËRKESA ËSHTË JO E PLOTË OSE E PAQARTË.....	43
4.RIPËRSËRITJA E KËRKESËS.....	44
5.KEQPËRDORIMI I TË DREJTËS NË PETICION.....	45
<b>LISTA E RASTEVE TË CITUARA TË GJYKATËS KUSHTETUESE .....</b>	<b>46</b>
<b>LISTA E RASTEVE TË CITUARA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT .....</b>	<b>53</b>

# SHKURTESAT

<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>Gjykata</b>	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>Kushtetuta</b>	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
<b>Ligji</b>	Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
<b>Rregullorja e punës</b>	Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovë nr. 01/2023

# I. HYRJE

**Q**ëllimi i këtij Udhëzuesi është që të informojë komunitetin juridik, në veçanti përfaqësuesit e palëve dhe vetë palët, në lidhje me kriteret e pranueshmërisë së kërkesave individuale të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh rëndësinë e të kuptuarit të kriterëve të pranueshmërisë nga ana e palëve para Gjykatës, ashtu që kërkesat e tyre të kenë mundësinë t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm në merita, ky Udhëzues praktik ka për qëllim të qartësojë praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese lidhur me interpretimin e kriterëve të pranueshmërisë për kërkesat individuale.

Paragrafi 7 i nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, legjitimon personat juridikë dhe fizikë si palë të autorizuara për të kontestuar aktet e autoriteteve publike që sipas tyre, kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre themelore të garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës. Kriteret e pranueshmërisë paraqesin standardet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese duhet të plotësojë në mënyrë që pretendimet e palës në atë kërkesë të mund t'i nënshtrohen vlerësimit në merita. Për sa u përket kërkesave individuale, këto kriterë saktësohen fillimisht përmes paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, ndërsa detajohen më tej përmes Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2023.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese, përmes neneve 46 (Lejueshmëria), 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës), saktëson ato që shquhen si kriterë procedurale të pranueshmërisë. Të tilla konsiderohen detyrimi i shterimit të mjeteve juridike, dorëzimi i kërkesës në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar, identifikimi dhe saktësimi i aktit të autoritetit publik, si dhe i të drejtave dhe lirive themelore të garantuar më Kushtetutë, të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur. Rregullorja e punës e Gjykatës qartëson më tutje disa aspekte lidhur me pranueshmërinë e një kërkesë individuale. Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) i Rregullores së punës, krahas përcaktimit të detyrimit të plotësimit të kriterëve procedurale të pranueshmërisë së kërkesës, detajon më tej edhe detyrimin e palës për të plotësuar kërkesën në rastet kur një kërkesë konsiderohet që është qartazi e bazuar. Ky rregull po ashtu saktëson kriteret që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës, përkatësisht kriteret nëse një kërkesë është brenda juridiksionit lëndor, personal, kohor dhe territorial të Gjykatës. Më tutje, rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) i Rregullores së punës, përcakton procedurën për hedhje poshtë të një kërkesë në procedurë të shkurtër, përfshirë bazën e refuzimit kur një kërkesë (i) nuk përbën objekt të shqyrtimit për shkak të mosplotësimit të kriterëve të pranueshmërisë ose për shkak se është e paqartë, apo (ii) kur një kërkesë është ripërsëritje e një kërkesë tashmë të vendosur nga Gjykata.

Përmes shtjellimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës që ndërlidhet me kriteret e pranueshmërisë së një kërkesë individuale, ky Udhëzues, mes tjerash, synon (i) t'i udhëzojë parashtruesit e kërkesave dhe/apo përfaqësuesve të tyre ligjor lidhur me përgatitjen e kërkesave; (ii) uljen e numrit të kërkesave të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese, të cilat nuk i plotësojnë kriteret procedurale për t'u shqyrtuar në merita; dhe për rrjedhojë (iii) rritjen e numrit të kërkesave të pranueshme, të cilat mund t'i nënshtrohen vlerësimit të mëtejshëm në merita.

Natyra dhe struktura e këtij dokumenti është frymëzuar nga Udhëzuesi praktik për kriteret e pranueshmërisë i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i qasshëm publikisht përmes ueb-faqes së kësaj Gjykate, si dhe përmes ueb-faqes së Gjykatës Kushtetuese.

Në shtatë kapituj përmbajtësor dhe duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe me raste, edhe në atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ky Udhëzues përvijon dhe shtjellon kriteret dhe aspekte të caktuara sa i përket pranueshmërisë së kërkesave individuale. Kriteret e pranueshmërisë së kërkesave individuale, siç burojnë nga Kushtetuta dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese, e që detajohen përmes Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese dhe të ilustruara përmes praktikës gjyqësore, janë paraqitur këtu të organizuara në grupe dhe nëngrupe tematike.

Në vijim të kapitullit të parë hyrës, Kapitulli II trajton grupin e kriterëve të pranueshmërisë që shquhen si baza procedurale për pranueshmëri. Këtu hyjnë një varg çështjesh të ndërlidhura me palën e autorizuar, përfshirë por pa u kufizuar (i) në shtjellimin se çfarë përbën person fizik apo juridik në kontekst të të qenit palë të autorizuar/parashtruese të kërkesave; (ii) në çfarë rrethana mund t'i njihet dikujt statusi i viktimës në kontekst të pranueshmërisë së një kërkesë individuale; dhe (iii) cilat janë kërkesat sa i përket përfaqësimit dhe cilat janë specifikat dhe pasojat që rrjedhin nga tërheqja e një kërkesë individuale në kontekst të shqyrtimit të pranueshmërisë së të njëjtës. Kapitulli III vijon me shtjellimin e shterimit të mjeteve juridike, si kriter kushtetues i pranueshmërisë së kërkesave individuale. Ilustruar nga praktika relevante gjyqësore e konsoliduar e kësaj Gjykate por edhe e asaj Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ky kapitull zbërthen këtë kriter në kuptimin e tij formal-procedural dhe atë përmbajtësor. Në Kapitullin IV trajtohet në detaje kriteri i pranueshmërisë së një kërkesë individuale të paraqitet para Gjykatës katër (4) muaj nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi përfundimtar gjyqësor lidhur me çështjen. Kjo pjesë fillimisht prezanton qëllimin dhe frymën e vendosjes së një afati ligjor dhe më tej, shtjellon nocionin e vendimit përfundimtar si fakt vendimtar në lidhje me llogaritjen e afatit. Tutje, Kapitulli V vazhdon me shtjellimin e kriterit kushtetues dhe ligjor që pala të precizojë të drejtat dhe liritë që pretendon t'i jenë shkelur. Kapitulli VI trajton kërkesat qartazi të pabazuara, si kategori e kërkesave të papranueshme në rrethanat kur konkluzioni rreth papranueshmërisë rrjedh nga një shqyrtim *prima-facie* i meritave të kërkesës. Këtu paraqiten nën-kategoritë e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e që ndërlidhen me pretendimet e (i) "*shkallës së katërt*"; (ii) mungesën e dukshme ose evidente të shkeljes; (iii) pretendimet e "*pambështetura dhe paarsyetuara*"; dhe (iv) pretendimet "*konfuze ose të paqarta*". Kapitulli VII shtjellon pranueshmërinë e një kërkesë individuale në kontekst të pajtueshmërisë së saj me juridiksionin e Gjykatës, të zbërthyer si juridiksion lëndor, personal, kohor e territorial. Në fund, Kapitulli VIII i kushtohet hedhjes poshtë dhe refuzimit të kërkesës, me saktësisht rrethanat kur një rast nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm, nuk përfaqëson një kontest, kur kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, e ripërsëritur ose kur përbën keqpërdorim të së drejtës në petition.

Duhet theksuar, megjithatë, se ky dokument është i natyrës informuese. Shtjellimet dhe çfarëdo reference e përdorur në këtë Udhëzues, duhet të kuptohen dhe interpretohen në kontekstin e rrethanave faktike dhe juridike të rastit përkatës të vendosur. Prandaj, duke qenë se secili rast ngërthen aspekte thujse unike faktike e juridike dhe vlerësimi i pranueshmërisë i nënshtrohet shqyrtimit të veçantë rast pas rasti nga Gjykata, referenca në këtë Udhëzues nuk nënkupton detyrimisht rezultatin e caktuar para Gjykatës.



Për më tepër, duhet të sqarohet se përmbajtja e këtij dokumenti nuk është shteruese. Ky dokument shtjellon kriteret e pranueshmërisë bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, për aq sa e njëjta është e konsoliduar në momentin e publikimit të tij. Lidhur me ato çështje të cilat ende nuk i janë nënshtruar trajtimit të Gjykatës dhe rrjedhimisht praktika gjyqësore e saj, nuk është e shtjelluar, Udhëzuesi i referohet praktikës relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Marrë parasysh natyrën dinamike dhe zhvillimin e vazhdueshëm të praktikës gjyqësore, ky Udhëzues, ashtu siç që rasti edhe Udhëzuesin e ngjashëm të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, do t'i nënshtrohet përditësimit të vazhdueshëm.

Të gjitha vendimet e referuara në këtë Udhëzues janë të publikuara në uebfaqen e Gjykatës dhe të qasshme në gjuhën shqipe dhe atë serbe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe në gjuhën angleze dhe në raste të caktuara, edhe në frengjisht. Të gjitha vendimet e referuara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë të qasshme në gjuhët përkatëse në ueb faqen e saj.

# II. BAZAT PROCEDURALE PËR PAPANUESHMËRI

## 1. PALA E AUTORIZUAR

### Paragrafi 1 i nenit 47 (Kërkesa individuale) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
[...]

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (a) i Rregullores së punës

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:  
(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;  
[...]

Bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, individët janë të autorizuar t'i drejtohen Gjykatës lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Për qëllime të ankimit individual, koncepti i individit i referuar në paragrafin 7 të nenit të lartcekur të Kushtetutës, interpretohet në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, sipas të cilit, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme. Bazuar në këto dy dispozita kushtetuese, individët, përkatësisht personat fizikë dhe juridikë, janë palë të autorizuar për t'ju drejtuar Gjykatës lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive përkatëse kushtetuese nga autoritetet publike, nën kushtet e përcaktuara në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

Për qëllime të shtjellimit të konceptit të palës së autorizuar dhe kriterëve që duhet të përmbushen në këtë kontekst, theks gjithashtu duhet të vihet në formulimin e paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe i cili, përkitazi me individët, ndër tjerash, kushtëzon ngritjen e pretendimeve para Gjykatës në të drejtat dhe liritë "e tyre individuale". Të njëjtin kushtëzim e përcakton edhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese në paragrafin 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të tij, duke u referuar në të drejtat dhe liritë "e tija individuale" përkitazi me individin. Bazuar në leximin e përbashkët të këtyre dy dispozitave, përfshirë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të saktësohet që për qëllime të plotësimit të kriterit të palës së autorizuar para Gjykatës, individit duhet të ketë statusin e viktimës. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së edhe asaj të Gjykatës dhe siç do të shtjellohet më detajisht në vijim, statusi i viktimës, mund të jetë (i) direkt ose i drejtpërdrejtë; (ii) indirekt ose i tërthortë; ose (iii) potencial.

## 1.1 KATEGORITË E PALËVE TË AUTORIZUARA/PARASHTRUESVE TË KËRKESAVE

Për qëllime të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese nga autoritetet publike, para Gjykatës, mund të paraqiten (i) personat fizikë; (ii) personat juridikë; dhe (iii) grupe individësh fizikë dhe/ose juridikë, me kushtin që të kenë statusin përkatës të viktimës. Në vijim, do të shtjellohen parimet e përgjithshme të aplikueshme për secilën prej këtyre kategorive siç janë shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe/ose GJEDNJ-së, atëherë kur praktika gjyqësore e Gjykatës nuk është e formësuar apo konsoliduar mjaftueshëm.

### 1.1.1 Personat Fizikë

Çdo person fizik mund të parashtrorë kërkesë në Gjykatë duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive përkatëse individuale nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, përmes praktikës përkatëse gjyqësore, Gjykata u ka njohur cilësinë e palës së autorizuar para Gjykatës edhe familjarëve të cilët kanë parashtruar kërkesa në emër të personave të vdekur, për aq sa është argumentuar cilësia e statusit të viktimës indirekte ose të tërthortë. Të tilla janë dy (2) raste të Gjykatës që ndërlidhen me pretendime për shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtje të së drejtës për jetën të garantuar sipas nenit 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës dhe nenit 2 (E Drejta për Jetën) të KEDNJ-së, përkatësisht (i) prindërve *Gëzim dhe Makfire Kastrati* lidhur me kërkesën e parashtruar në emër të bijës së tyre të ndjerë D.K. (shih, rastin e Gjykatës [KI41/12](#), me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013, paragrafët 41-45); dhe (ii) të bijës *Velderda Sopi* lidhur me kërkesën e parashtruar në emër të nënës së saj, përkatësisht të ndjerës S.M. (shih, rastin e Gjykatës [KI129/21](#), me parashtruese *Velderda Sopi*, Aktgjykim i 7 marsit 2023, paragrafët 102-109). Për më tepër, në kontekst të pretendimeve për shkelje të së drejtës për jetë private dhe familjare, të garantuar sipas nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës dhe nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, Gjykata i ka njohur cilësinë e palës së autorizuar prindit *Ahmet Frangu* në kërkesën e parashtruar në emër të të birit të tij të ndjerë (shih, rastin e Gjykatës [KI56/18](#), me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafët 56-67).

Në anën tjetër, cilësia e palës së autorizuar u është njohur edhe parashtruesve përkatës të cilët kanë vdekur pas parashtrimit të kërkesës përkatëse në Gjykatë. Në rrethanat të tilla, Gjykata ka vazhduar me trajtimin e kërkesës përkatëse ose jo, varësisht nëse trashëgimtarët përkatës kanë kërkuar që Gjykata të vazhdojë me trajtimin e kërkesës ose jo (shih, për shembull rastin e Gjykatës [KI77/20](#), me parashtrues *Kujtim Zarari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 30-36; për dallim nga rasti i Gjykatës [KI161/20](#), me parashtrues *Bedri Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shtatorit 2021, paragrafët 43-46). Megjithëse Gjykata nuk ka ende praktikë gjyqësore, sipas GJEDNJ-së, në raste të jashtëzakonshme, procedura në një rast mund të vazhdohet edhe pas vdekjes së parashtruesit përkatës, nëse vlerësohet që rasti nuk ndërlidhet me një çështje që paraqet vetëm interes individual për parashtruesin, por ekziston interes i gjerë për ngritjen e standardeve të përgjithshme dhe zgjerimit të jurisprudencës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Paposhvili kundër Belgjikës*, nr.41738/10, paragrafët 129-133).

Cilësinë e palës së autorizuar, Gjykata ua ka njohur edhe shtetasve të huaj, për aq sa kanë kontestuar akte të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës. I tillë është shembulli i rastit [KI39/20](#), me parashtrues *Cihan Ozkan*, shtetas i Republikës së Turqisë, dhe të cilin para Gjykatës e ka përfaqësuar një avokat i Republikës së Kosovës me autorizim të bashkëshortes së parashtruesit të kërkesës. Gjykata, marrë parasysh rrethanat

specifike të parashtruesit të kërkesës dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të njëjtit ia ka njohur cilësinë e palës së autorizuar para Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës KI39/20, me parashtrues *Cihan Ozkan*, cituar më lart, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafët 61-81; shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI230/19](#), me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafët 80-82). Të njëjtën qasje Gjykata e ka ndjekur edhe në kontest të personave juridikë me seli në një shtet të huaj (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI123/19](#), me parashtrues "*SUVA Rechtsabteilung*", Aktgjykim i 13 majit 2020, paragrafi 51).

Përderisa Gjykata nuk ka trajtuar ende ndonjë rast të tillë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, (i) mungesa e zotësisë për të vepruar nuk është pengesë për të paraqitur kërkesë para Gjykatës edhe pa pëlqimin e kujdestarit përkatës (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Zehentner kundër Austrisë](#), nr.20082/02, Aktgjykim i 16 korrikut 2009, paragrafi 39); dhe (ii) amësia natyrale e nënës që i është hequr e drejta prindërore mjafton si autorizim për të ngritur në Gjykatë një rast në emër të fëmijëve të saj për të mbrojtur interesat e tyre (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së [Scozzari dhe Giunta kundër Italisë](#), nr. 39221/98 41963/98, Vendim i 15 shtatorit 1998, paragrafi 138).

Për më tepër, Gjykatës mund t'i drejtohen edhe grupe individësh, për aq sa kontestojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre individuale para saj. Një qasje e tillë është përcaktuar që në filltet e funksionimit të Gjykatës, duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër tjerash përmes rastit [KI40/09](#), me parashtrues *Imer Ibrahim* dhe *48 Ish-Punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, Aktgjykim i 16 qershorit 2010, paragrafët 34-48; dhe është konsoliduar më tej, ndër tjerash, përmes rasteve (i) [KI182/20](#), me parashtrues *Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi*, Aktgjykim i 20 janarit 2022, paragrafët 52-54; dhe (ii) [KI140/22](#), me parashtrues *Imer Mustafa dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 36.

### 1.1.2 Personat Juridikë

Siç është theksuar më lart, bazuar në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, personat juridikë janë palë të autorizuar para Gjykatës për aq sa ngritin pretendime për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tyre. Një qasje e tillë është përcaktuar që në filltet e funksionimit të Gjykatës, duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër tjerash, përmes rastit [KI41/09](#), me parashtrues Universiteti AAB-Riinvest L.L.C, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 nëntorit 2009, paragrafi 14; dhe është konsoliduar më tej, ndër tjerash, përmes rastit të Gjykatës [KI75/21](#), me parashtrues "*Abrazen LLC*", "*Energy Development Group Kosova LLC*", "*Alsi & Co. Kosovë LLC*" dhe "*Building Construction LLC*", Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 51; dhe [KI35/18](#), me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverband*", Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40). Përtej personave juridikë të cilët janë të regjistruar si të tillë bazuar në legjislacionin e aplikueshëm, përkatësisht Ligjin e aplikueshëm për Shoqëri Tregtare, në përcaktimin nëse pala para Gjykatës ka cilësinë e personit juridik, Gjykata ka vlerësuar edhe ligjet tjera të aplikueshme, siç është rasti me Ligjin e aplikueshëm për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili defnon AKP-në si person juridik dhe për pasojë, palë të autorizuar para Gjykatës (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI25/10](#), me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktgjykim i 30 marsit 2011, paragrafi 39).

Për më tepër dhe bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, cilësinë e personit juridik dhe rrjedhimisht, të palës së autorizuar para Gjykatës, bazuar në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, e kanë edhe: (i) institucionet shtetërore, përfshirë komunat, me këto të fundit me të drejtën për të kontestuar aktet e autoriteteve publike bazuar në paragrafin 7 të jenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, përveç autorizimit që bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës të kontestojnë edhe kushtetutshmërinë e ligjeve apo akteve të Qeverisë që cenojnë përgjegjësitë komunale apo zvogëlojnë të hyrat e komunës (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI82/21](#), me parashtrues *Komuna e Gjakovës*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2021, paragrafi 75; [KI31/18](#), me parashtrues *Komuna e Pejës*, Aktgjykim i 12 prillit 2019, paragrafi 112; [KI149/16](#), me parashtrues *Komuna e Klinës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 tetorit 2017, paragrafi 36; dhe [KI57/16](#), me parashtrues *Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 korrikut 2017, paragrafi 24; (ii) subjektet politike (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI207/19](#), me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 80; [KI27/20](#), me parashtrues *Lëvizja Vetëvendosje!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafët 40-41; dhe [KI59/21](#), me parashtrues *Partia Demokratike e Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2021, paragrafi 37); (iii) organizatat jo-qeveritare (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI229/19](#), me parashtrues *Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 64; dhe [KI20/15](#), me parashtrues *Organizata Joqeveritare FINCA - Kosovë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 31 korrikut 2015); (iv) bashkësitë fetare (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI126/18](#), me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 70); (v) institucionet dhe klubet sportive (shih, rastet e Gjykatës [KI37/19](#), me parashtrues *Federata e Taekwondo e Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 dhjetorit 2019, paragrafët 57-58; dhe [KI88/20](#), me parashtrues *Klubi i Futbollit "Liria"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 shtatorit 2020, paragrafët 18-19); dhe (vi) sindikatat (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI10/22](#), me parashtrues *Sindikata e Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022, paragrafi 44).

## 1.2 STATUSI I VIKTIMËS

Siç është sqaruar më lart, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, individët janë të autorizuar që para Gjykatës të ngritin pretendime për shkeljen e të drejtave dhe lirive "të tyre" nga autoritet publike. Kushtëzimi që individët t'i drejtohen Gjykatës vetëm përkitazi me shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre individuale, nënkupton që të njëjtit para Gjykatës duhet të kenë statusin e viktimës. Andaj, Gjykata, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mbajtur qëndrimin se Kushtetuta nuk parashih konceptin e *actio popularis*, që do t'i mundësonte çdo individ të kontestojë para Gjykatës dispozitat e caktuara ligjore apo aktet e autoriteteve publike me pretendimin e mbrojtjes së interesit publik dhe/ose rendit kushtetues (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI30/19](#), me parashtrues *Isni Kryeziu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2019, paragrafët 28-30).

Përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka sqaruar që individët nuk janë palë të autorizuar për të kontestuar një ligj. Thënë këtë, nga ky parim, mund të ketë përjashtime dhe rrethanat në të cilat ky mund të jetë rasti, janë sqaruar në rastin e Gjykatës [KI185/21](#), me parashtrues *SHPK "CO COLINA"*. Përmes këtij rasti, Gjykata ka sqaruar që individët mund të kenë statusin e viktimës në rastet kur kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji, vetëm nëse argumentohet që individ i përkatës (i) është afektuar drejtpërdrejt nga ligji në fjalë; dhe (ii) nëse lidhur me ligjin përkatës nuk ekzistojnë masa pasuese zbatuese nga autoritet publike (shih, rastet e Gjykatës [KI136/19](#), me parashtrues *SHPK "CO COLINA"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, paragrafët 81-96; dhe [KI185/21](#), me parashtrues *SHPK "CO COLINA"*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2023, paragrafët 77-136).

Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, termi “viktimë” nuk mund të interpretohet vetëm formalisht dhe në mënyrë të izoluar nga rrethanat e rastit dhe përmbajtja e kërkesës përkatëse (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës KI10/22, cituar më lart, paragrafët 44-48; dhe shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, [Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës](#), nr. 62543/00, Vendim i 27 prillit 2004, paragrafi 38). Në raste të caktuara, ekzistimi i statusit të viktimës mund të jetë i lidhur me llojin e shkeljeve të cilat pretendohet të jenë kryer dhe trajtimit të meritave të rastit përkatës (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Siliadin kundër Francës](#), nr. 73316/01, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 63). Përderisa edhe barra e provës përkitazi me statusin e viktimës, përkatësisht nëse e njëjta bie mbi parashtruesin e përkatës ose autoritetin publik, varet nga rrethanat e rastit dhe përmbajtja e kërkesës përkatëse (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [N.D. dhe N.T. kundër Spanjës](#), nr. 8675/15 dhe 8697/15, paragrafët.83-88).

Në vijim, do të shtjellohet praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përkitazi me kategoritë e statusit të viktimës përkatësisht statusin e viktimës (i) direkte ose të drejtpërdrejtë; (ii) indirekte ose të tërthortë; ose (iii) potenciale.

### 1.2.1 Viktima direkte ose e drejtpërdrejtë

Siç është sqaruar më lart, kërkesat para Gjykatës, duhet të parashtrihen nga individë të cilët pretendojnë që janë viktima të shkeljes së një ose më shumë të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Të njëjtit, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, duhet të dëshmojnë dhe argumentojnë që janë “prekur drejtpërdrejtë” nga masat e autoriteteve publike ndaj të cilave ankohen (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës (i) [KI29/09](#), [KI32/09](#) dhe [KI47/09](#), me parashtrues *Teki Bokshi, Avdi Rizvanolli and Qaush Smajlaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2010, paragrafi 22; (ii) [KI32/21](#), me parashtrues *Hasan Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 qershorit 2021, paragrafët 43-47; (iii) [KI175/19](#), me parashtrues *Ismajl Zogaj*, Aktgjykim i 1 korrikut 2021, paragrafi 60; (iv) KI39/20, cituar më lart, paragrafët 64 dhe 65; dhe (v) [KI118/10](#), me parashtrues *Shoqata e Sigurimeve të Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 23 majit 2011, paragrafët 14-19).

Gjithashtu, përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata ka sqaruar që individët mund të kontestojnë edhe vendimet e Qeverisë, vendimet e Kuvendit dhe dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës, me kushtin që t’i kenë shteruar mjetet efektive të përcaktuara me ligj (shih, rastet e Gjykatës [KI147/18](#), me parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 shtatorit 2019, paragrafëve 51-61, në kontekst të të drejtës së individëve për të kontestuar vendimet e Kuvendit; [KI186/21](#), me parashtrues *Faik Miftari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 dhjetorit 2021, paragrafët 31-33, në kontekst të të drejtës së individëve për të kontestuar vendimet e Qeverisë; [KI74/21](#), me parashtrues *Halim Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 tetorit 2022, paragrafi 44, në kontekst të të drejtës së individëve për të kontestuar dekretet e Presidentes; dhe gjithashtu shih, rastin në të cilin Gjykata ka shtjelluar më detajisht rastet kur dekretet e Presidentes së Republikës i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga gjykatat e rregullta, përkatësisht Aktgjykim e Gjykatës [KI214/21](#), me parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafët 92-129).

Për më tepër, individët, përjashtimisht mund të kenë statusin e “viktimës” në rastet kur kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji, megjithatë, një status i tillë mund të fitohet vetëm përjashtimisht dhe vetëm nëse argumentohet që individi përkatës (i) është afektuar drejtpërdrejtë nga ligji në fjalë; dhe (ii) nëse lidhur me ligjin përkatës nuk ekzistojnë masa pasuese zbatuese nga autoritet publike (shih, rastet e Gjykatës KI136/19, me parashtrues *SHPK “CO COLINA”*, cituar më lart, paragrafi 96; dhe KI185/21, me parashtrues *SHPK “CO COLINA”*, cituar më lart, paragrafët 77-136).



Në parim, individët nuk mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimeve të nxjerra në procedura në të cilat nuk kanë qenë palë pranë autoriteteve respektive shtetërore (shih, rastin e Gjykatës [KI137/19](#), me parashtrues *Arlind Morina*, Aktvendim për Papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafët 33-38; dhe shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së [Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë](#), nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi 92). Megjithatë, për qëllime të pranueshmërisë, palë të autorizuara para Gjykatës konsiderohen edhe palët e treta, kur interesi i tyre preket drejtpërdrejtë nga rezultati përfundimtar i procedurave gjyqësore (shih, rastin e Gjykatës [KI149/11](#), me parashtrues *Shfaqet Aliu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2012, paragrafët 27-37; dhe shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, [Margulev kundër Ruisisë](#), nr. 15449/09, Aktgjykimi i 8 tetorit 2019, paragrafi 36). Në anën tjetër, Gjykata, përmes praktikës përkatëse gjyqësore, ka sqaruar që fakti se një individ është palë në procedurë para gjykatave të rregullta, nuk nënkupton se i njëjti gëzon statusin e “viktimës” para Gjykatës me automatizëm, nëse të drejtat individuale të tij nuk preken drejtpërdrejtë nga akti i kontestuar. Rrjedhimisht, pjesëmarrja apo jo e parashtruesit të kërkesës në procedurat para gjykatave të rregullta, nuk është vendimtare për të përcaktuar statusin e “viktimës” pasi ky nocion është autonom dhe interpretohet bazuar në kuptimin e palës së autorizuar, të përcaktuar me Kushtetutë, Ligj për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI32/21](#), me parashtrues *Hasan Shala*, cituar më lart, paragrafët 33-43).

### 1.2.2 Viktima indirekte ose e tërthortë

Si palë të autorizuara para Gjykatës mund të paraqiten edhe individët, të drejtat dhe liritë themelore të të cilëve, janë afektuar në mënyrë indirekte ose të tërthortë. Në kontekst të viktimës indirekte ose të tërthortë, praktika e Gjykatës është posaçërisht e konsoliduar në rrethana të pretendimeve para Gjykatës lidhur me dështimin e shtetit për të përmbushur detyrimet pozitive për mbrojtjen e të drejtës në jetë sipas garancive të nenit 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës dhe nenit 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së (shih, rastet e Gjykatës [KI41/12](#), cituar më lart, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindërit e të bijës së ndjerë; dhe [KI129/21](#), cituar më lart, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga vajza e të ëmës së ndjerës). Ngjashëm, Gjykata ka vepruar edhe në kontekst të së drejtës për privatësinë dhe jetën familjare, të garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit përkatës (shih, rastin [KI56/18](#), cituar më lart, lidhur me paraqitjen e kërkesës nga prindi i të ndjerit). Prandaj, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë, u është njohur vetëm familjarëve të ngushtë apo personave të afërm, të cilët kanë arritur të dëshmojnë se kanë interes legjitim lidhur me çështjen në fjalë (shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI77/20](#), cituar më lart, paragrafët 30-36, rast ky në të cilin Gjykata i ka pranuar cilësinë e viktimës indirekte ose të tërthortë, bashkëshortes së parashtruesit të kërkesës i cili kishte ndërruar jetë pas parashtrimit të kërkesës përkatëse në Gjykatë).

Megjithatë, sipas Aktgjykimeve në rastet [KI149/18](#), [KI150/18](#), [KI151/18](#), [KI152/18](#), [KI153/18](#) dhe [KI154/18](#), Gjykata bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, ka sqaruar më tej që këtë status e gëzojnë vetëm familjarët e ngushtë apo personat e afërm (“next-of-kin”), të cilët kanë arritur të dëshmojnë se kanë interes legjitim e të rëndësishëm mbi çështjen e personit të ndjerë (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI149/18](#), [KI150/18](#), [KI151/18](#), [KI152/18](#), [KI153/18](#), me parashtrues *Xhavit Aliu dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2019, paragrafi 62-75). Në këtë kontekst, statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë, mund t’ju akordohet personave të cilët ngritin pretendime rreth vdekjes apo zhdukjes së personit të tyre të afërm si dhe në raste të caktuara, partnerëve të pamartuar, motrave dhe vëllezërve, fëmijëve, nipërve dhe mbesave (shih, rastet [KI149/18](#), [KI150/18](#), [KI151/18](#), [KI152/18](#), [KI153/18](#), cituar më lart, paragrafët 68-70; dhe [KI11/20](#), me parashtruese *Fllanza Pozhegu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 46-56).

Për më tepër, Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore dhe duke u bazuar në atë të GJEDNJ-së, ka sqaruar që statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të "transferueshme" apo jo. Sipas sqarimeve të dhëna përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, të drejtat që ndërlidhen me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, në parim por me përjashtime, cilësohen si të drejta të "pa transferueshme". Në këtë kontekst, Gjykata nuk i ka njohur statusin e viktimës indirekte ose të tërthorë (i) të birit të të ndjerit përkatës, kur para Gjykatës janë kontestuar vendimet e gjykatave të rregullta me pretendime për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përgjatë të cilave palë në procedurë ishte babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës (shih, rastet e Gjykatës KI149/18, KI150/18, KI151/18, KI152/18, KI153/18, cituar më lart, paragrafi 74); dhe (ii) motrës së të ndjerës përkatëse, kur para Gjykatës janë kontestuar vendimet e gjykatave të rregullta me pretendime për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përgjatë të cilave palë në procedurë ishte motra e ndjerë e parashtrueses përkatëse (shih, rastin e Gjykatës KI11/20, me parashtruese *Fllanza Pozhegu*, cituar më lart, paragrafi 56). Njëjtë Gjykata ka vepruar edhe në rrethanat e rastit KI67/18, kur para Gjykatës është kontestuar një dekret i Presidentit të Republikës sipas të cilit ishte bërë falja e dënimit të personit i cili kishte vrarë babanë e parashtrueses së kërkesës, duke sqaruar se akti i kontestuar nuk kishte afektuar të drejtat dhe liritë themelore të saj dhe rrjedhimisht, duke mos i njohur statusin e viktimës indirekte ose të tërthortë (shih, rastin e Gjykatës [KI67/18](#), me parashtruese *Arbenita Arifi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 14 majit 2019, paragrafët 40-49).

Gjithashtu dhe edhe pse Gjykata nuk ka praktikë gjyqësore në këtë kontekst, relevante mund të jenë edhe rrethanat në të cilat statusi i viktimës indirekte ose të tërthorë mund t'i njihet personave juridikë, përkatësisht shoqërive tregtare ose organizatave jo-qeveritare. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në kontekst të kategorisë së shoqërive tregtare, GJEDNJ ka bërë dallimin në mes të rasteve kur aksionarët e një shoqërie të caktuar kontestojnë masat të cilat afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë aksionet e tyre ose masat që afektojnë shoqëritë tregtare në të cilat personat të ndryshëm janë aksionarë. Në rastin e parë, aksionarët e kanë statusin e viktimës indirekte ose të tërthortë, ndërsa në rastin e dytë, aksionarët përkatës nuk mund të gëzojnë këtë status (shih, rastet e GJEDNJ-së [Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 14807/89, Aktgjykimi i 24 tetorit 1995, paragrafët 65-66; dhe [Alberti dhe të tjerët kundër Hungarisë](#), nr.5294/14, Aktgjykimi i 7 korrikut 2020, paragrafë 122 -123). Përjashtim nga ky parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përbëjnë rastet kur palët e bindin Gjykatën që ngritja e rastit nga vet shoqëria tregtare është e pamundur (shih, rastin e GJEDNJ-së [Alberti dhe të tjerët kundër Hungarisë](#), cituar më lart, paragrafët 124 dhe 135-145).

Në kontekst të kategorisë së organizatave jo-qeveritare, përderisa të njëjtat mund të kenë statusin e viktimës direkte ose të drejtpërdrejtë kur të drejtat dhe liritë e tyre afektohen nga një akt i autoriteti publik, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të njëjtat, në parim, nuk mund të gëzojnë statusin e viktimës indirekte ose të tërthortë nëse të drejtat dhe/ose interesat e tyre nuk janë afektuar, madje as në rastet kur organizatat jo-qeveritare përkatëse janë themeluar për të mbrojtur grupe potenciale të viktimave (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Nencheva dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), kërkesa nr.48609/06, Aktgjykimi i 18 qershorit 2013, paragrafët 90 dhe 93). Megjithatë dhe përjashtimisht, në rrethana të caktuara, kur organizatat jo-qeveritare përkatëse përfaqësojnë interesat e parashtruesve në procedura të ndryshme para gjykatave vendore dhe nënkupton që ato janë të autorizuara të veprojnë në emër të një individi, të njëjtat mund të gëzojnë statusin e viktimës (shih, rastin e GJEDNJ, [Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës](#), nr.62543/00, paragrafët 37-39).



### 1.2.3 Viktimat potenciale

Siç është sqaruar më lart, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, individit para Gjykatës mund të ngritë pretendime lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij/saj kushtetuese, rrjedhimisht të ketë statusin e viktimës direkte ose të drejtpërdrejtë ose përjashtimisht, të viktimës indirekte ose të tërthortë. Gjykata ende nuk ka praktikë gjyqësore përkitazi me statusin e viktimës potenciale. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, një status i tillë, mund të njihet përjashtimisht në rrethana kur, për shembull, një i huaj është urdhëruar që të largohet nga vendi ndërsa urdhri ende nuk është zbatuar, por zbatimi i të njëjtit do të ekspozonte parashtruesin përkatës ndaj shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore në vendin ku do të dërgohej (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), Aktgjykim i 7 korrikut 1989). Në raste të tilla parashtruesit përkatës i duhet të dëshmojë shkeljen e mundshme të të drejtave dhe lirive personalisht ndaj tij/saj dhe një dyshim i përgjithshëm në këtë kontekst nuk është i mjaftueshëm (shih, rastin e GJEDNJ-së [Senator Lines GmbH kundër 15 shteteve të Bashkimit Evropian](#), nr. 56672/00, Vendim i 10 marsit 2004).

### 1.2.4 Actio Popularis

Përmes praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata ka sqaruar që Kushtetuta nuk e parasheh konceptin e *actio popularis*, koncept ky që i mundëson individit që të ngritë para Gjykatës kërkesa përmes të cilave pretendon të mbrojë interesin publik. Më saktësisht, një individ nuk mund t'i drejtohet Gjykatës me pretendime abstrakte lidhur me masat e autoriteteve publike të cilat nuk e kanë afektuar personalisht të njëjtin. Andaj, Gjykata në këto raste ka konstatuar se parashtruesit përkatës nuk janë palë të autorizuar për të parashtruar kërkesë para Gjykatës pasi që nuk mund të konsiderohen viktima të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të tyre. Këto raste, në të cilat Gjykata ka sqaruar mungesën e autorizimit të palës përkatëse për t'ju drejtuar asaj përmes konceptit të *actio popularis*, përfshijnë por nuk kufizohen në rastet kur: (i) një shoqatë kishte kontestuar një ligj të Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës [KI118/10](#), me parashtrues *Shoqata e Sigurimeve të Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 nëntorit 2011, paragrafët 14-19); (ii) një sindikatë kishte kërkuar nxjerrjen e akteve ligjore lidhur me pensionistët (shih, rastin e Gjykatës [KI84/12](#), me parashtrues *Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012, paragrafët 26-29); (iii) një organizatë jo-qeveritare kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së një protokollit në mes dy institucioneve (shih, rastin e Gjykatës [KI43/09](#), me parashtrues *Lëvizja FOL*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 majit 2011, paragrafët 21-24); (iv) një individ kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së rregullores së një ministrie (shih, rastin e Gjykatës [KI30/19](#), *Isni Kryeziu*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 prillit 2019, paragrafët 28-32); (v) disa individë kishin kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së një vendimi të Qeverisë (shih, rastin e Gjykatës [KI170/21](#), *Arianit Sllamniku dhe të tjerët*, Aktvendim i 10 dhjetorit 2021, paragrafët 36-42); dhe (vi) një individ kishte kërkuar vlerësimin e një vendimi të Kuvendit Komunal të Prizrenit (shih, rastin e Gjykatës [KI117/11](#), me parashtrues *Ridvan Hoxha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 korrikut 2012, paragrafët 21-26).

### 1.2.5 Humbja e statusit të viktimës

Çështja nëse një palë para Gjykatës, përkatësisht parashtrues i kërkesës, ka statusin e viktimës është relevante gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë. Atëherë kur është relevante të vlerësohet nëse ekziston më tutje statusi i viktimës së një pale para Gjykatës, kjo e fundit duhet të vlerësojë statusin e parashtruesit të kërkesës dhe rrethanat përkatëse pas parashtrimin të kërkesës. Në rastin [KI11/09](#), me parashtrues *Tomë Krasniqi*, Gjykata pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatë, përmes së cilës parashtruesi përkatës ankohej lidhur me detyrimin për pagesën për televizionit publik përmes faturave të rrymës, kishte

vlerësuar nëse i njëjti kishte ende statusin e viktimës duke marrë parasysh që marrëveshja kontraktuese në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe Radio Televizionit të Kosovës, kishte përfunduar dhe parashtruesi përkatës nuk kishte më tutje detyrimin e pagesës së tarifës për televizionin publik përmes faturës së rrymës, dhe rrjedhimisht, nuk e kishte më statusin e viktimës (shih, rastin [KI11/09](#), me parashtrues *Tomë Krasniqi*, Vendim për Heqje nga Lista e Kërkesës, i 17 majit 2011, paragrafët 40-48). Gjithashtu, në rastet [KI58/12](#), [KI66/12](#) dhe [KI94/12](#), Gjykata kishte konstatuar që vendimet e komunave lidhur me kushtëzimin e pagesës së obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike, të cilat ishin kontestuar para Gjykatës, në ndërkohë ishin shfuqizuar dhe rrjedhimisht, çështja ishte zgjidhur në favor të parashtruesve të kërkesave, dhe për pasojë, të njëjtit nuk gëzonin më tutje statusin e viktimës (shih, rastet e Gjykatës [KI58/12](#), [KI66/12](#) dhe [KI94/12](#), me parashtrues *Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunal të KK të Vitisë*, Vendim për Heqje nga Lista e Kërkesës, i 5 korrikut 2013, paragrafët 49-51).

Gjithashtu, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, parashtruesi i kërkesës (i) e humb statusin e viktimës nëse pas parashtrimin të kërkesës përkatëse, autoriteti publik ka konstatuar shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij/saj dhe i ka akorduar kompensimin përkatës, i cili duhet të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Scordino kundër Italisë](#), nr.36813/97, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 180); ndërsa, parashtruesi (ii) nuk e humb statusin e viktimës nëse pas parashtrimin të kërkesës përkatëse, autoriteti publik ka konstatuar shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij/saj, por nuk i ka akorduar kompensim përkatës, përpos nëse individi ka mjete efektive juridike në dispozicion për të kërkuar kompensimin adekuat (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Kudić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës](#), nr. 28971/05, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2008, paragrafët 17-18).

### 1.3 PËRFAQËSIMI

Bazuar në nenin 21 (Përfaqësimi) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, palët gjatë procesit para Gjykatës mund të përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala. Autorizimi për përfaqësimin e një parashtruesi të kërkesës para Gjykatës gjithashtu është i saktësuar në shkronjën (c) të pikës 2 të rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën e saj gjyqësore, në parim, në ato kërkesa në të cilat palët përkatëse nuk kanë dorëzuar autorizimin për përfaqësim, bazuar në rregullin 26 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit të kërkesës) të Rregullores, Gjykata i drejtohet palëve me kërkesë për plotësimin e dokumentacionit, përkatësisht dorëzimin e autorizimit të vlefshëm për përfaqësim në Gjykatë. Në ato raste kur kërkesa e parashtruar në Gjykatë nuk plotësohet me autorizim sipas kërkesës së Gjykatës, kjo e fundit refuzon kërkesën përkatëse me procedurë të shkurtër. Praktika gjyqësore e Gjykatës, parashtruesit e tillë të kërkesave dhe të cilët dështojnë të paraqesin para Gjykatës autorizimin përkatës, i trajton si përfaqësues të pretenduar dhe në rrethanat të tilla, në mungesë të një autorizimi, nuk shtjellon në vendimin e saj detajet mbi faktet dhe rrethanat e rastit dhe pretendimet përkatëse (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, [KI25/21](#), me parashtrues, *Ymer Koro, si përfaqësues i pretenduar i K.Lj. dhe K.B.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 21 korrikut 2021, paragrafët 22-32; dhe [KI137/20](#), me parashtrues, *Ali Latifi, si përfaqësues i pretenduar i M.S.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 20-22). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, përderisa autorizimi përkatës duhet të jetë i nënshkruar nga vet parashtruesi i kërkesës, përjashtimisht, është pranuar autorizimi për avokatin e parashtruesit të kërkesës të nënshkruar nga bashkëshortja e tij, duke marrë parasysh rrethanat specifike të rastit përkatës (shih, rastin e Gjykatës [KI39/20](#), me parashtrues *Cihan Ozkan*, cituar më lart, paragrafët 61-81).

Për më tepër, sipas praktikës së GEDNJ-së, ekzistojnë përjashtime kur një person përfaqësohet para GJEDNJ nga një person tjetër. Në këtë kontekst, të miturit, në parim, përfaqësohen në Gjykatë nga prindërit e tyre. Në këto raste, atësia/amësia i mjafton atij/asaj si autorizim për të ngritur çështje para Gjykatës. Andaj, të drejtën për të iniciuar një kërkesë në emër të të miturit e kanë prindërit të cilët nuk janë privuar nga të drejtat prindërore. Megjithatë, GJEDNJ në një rast kishte vlerësuar që edhe pse nënës i është hequr e drejta prindërore, statusi i saj si nënë natyrale, i mjafton asaj për të parashtruar një kërkesë në emër të fëmijëve të saj, për të mbrojtur të drejtat e fëmijës së saj (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 138).

Përjashtimisht, po ashtu në kontekst të viktimave lidhur me të drejtën në jetë, ndalimin e torturës apo të drejtë për jetë private, duhet të ketë konsiderata të veçanta sa i përket përfaqësimit përkatës. Për pasojë, GJEDNJ në disa raste ka shpallur të pranueshme kërkesat e OJQ-ve të cilat kanë iniciuar rastet në emër të viktimave, për përfaqësimin e të cilëve nuk kishin autorizim. Në këto raste, GJEDNJ ka theksuar faktin që viktimat në fjalë nuk kishin të afërm dhe as përfaqësues ligjorë për të iniciuar rastet në emër të tyre dhe se OJQ-të përkatëse, ndonëse nuk kanë pasur autorizim, (i) kanë pasur disa marrëdhënie me viktimat përkatëse para se të njëjtit të ndërronin jetë; si dhe/ose (ii) kërkesat e ngritura ngërthenin pretendime për shkelje serioze të KEDNJ-së, mos trajtimi i të cilave do ta lironte shtetin nga akuzat serioze për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë](#), nr.47848/08, Aktgjykim i 17 korrikut 2014, paragrafët 104-114; dhe \_\_\_\_\_ nr.2959/11, Aktgjykimi i 24 marsit 2015, paragrafët 40-46).

## 1.4 TËRHEQJA E KËRKESAVE NGA PALËT

Për më tepër, paragrafi 1 i rregullit 31 (Tërheqja e palëve nga procedura) i Rregullores së punës së Gjykatës përcakton që parashtruesi/ja e kërkesës mund të tërheqë kërkesën në çdo kohë para shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Gjykatës. Megjithatë dhe pavarësisht se kjo ndërlidhet me statusin dhe/ose humbjen e statusit të viktimës, sipas paragrafit 2 të të njëjtit rregull, Gjykata mund të vazhdojë me shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës, kur në vlerësimin e saj, vazhdimi i procedurës është në interesin publik dhe/ose respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë (shih, rastet Gjykatës lidhur me kërkesa individuale, kur është aprovuar kërkesa e palëve për tërheqje të kërkesave, ndër tjerash, në rastin [KI04/17](#), me parashtrues Z. K., Vendim për tërheqje të kërkesës, i 2 qershorit 2017, paragrafi 19; dhe [KI110/17](#), me parashtrues *Sekule Stanković*, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 24 majit 2018, paragrafi 18). Për dallim nga rastet e lartcekura, kur Gjykata ka vlerësuar se vazhdimi i shqyrtimit të rastit të caktuar, përkundër kërkesës së palës përkatëse për tërheqjen e rastin, është në interesin publik dhe/ose mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore, Gjykata ka refuzuar kërkesën për tërheqje të kërkesës (shih, rastet e Gjykatës [KO145/21](#), me parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Aktgjykim i 10 marsit 2022, paragrafët 89-94; [KO173/21](#), me parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafët 76-88).

# III. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE

## Paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës

*"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

## Paragrafi 2 i neni 47 (Kërkesa individuale) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese

[...]

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

## Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (b) i Rregullores së Punës

*"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

*(b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktit të kontestuar ..."*

## 1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E DETYRIMIT KUSHTETUES PËR SHTERIMIN E MJETEVE EFEKTIVE JURIDIKE

Paragrafi 7 i nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës dhe paragrafi 2 i nenit 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe nënparagrafit (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së Punës, përcaktojnë detyrimin për shterimin e mjeteve juridike, i cili detyrim përbën një nga kriteret parësore të pranueshmërisë së një kërkesë individuale të parashtruar në Gjykatë. Ky detyrim në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhet edhe me respektimin e parimit të subsidiaritetit. Në këtë kontekst, Gjykata duke afirmuar edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vazhdimësi ka theksuar se qëllimi dhe arsyeimi i rregullit për të shteruar mjetet juridike, është që t'ju ofrojë autoriteteve përkatëse dhe para së gjithash, gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, ky rregull bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, që rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, para se rasti të referohet në Gjykatën Kushtetuese (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [K1179/20](#), me parashtrues *Telekom i Kosovës Sh.A*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafi 94).

Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore, gjithashtu ka sqaruar që shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në të gjitha instancat me juridiksion të plotë (shih, ndër tjerash rastet e Gjykatës, [KI219/21](#), me parashtrues *Isuf Ferati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafët 26 dhe 28; dhe [KI193/20](#), me parashtrues *Bujar Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 majit 2021, paragrafët 26-28; dhe rastet e GJEDNJ-së, *Civet kundër Francës*, kërkesa nr. 29340/95, Aktgjykim i 28 shtatorit 1999, paragrafi 41; *Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë*, kërkesat nr. 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04, 21819/04, Vendim i 10 marsit 2010, paragrafët 69 dhe 97); dhe (ii) atë të shterimit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë/përmbajtje*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), me parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; [KI119/17](#), me parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2019, paragrafi 73; [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”* Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 94; dhe [KI40/20](#), me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafët 66-69).

Bazuar në këtë detyrim, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se parashtruesit e kërkesës janë përgjegjës, kur rastet e tyre përkatëse shpallen si të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore në procedurë para gjykatave të rregullta (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI139/12](#), me parashtrues *Besnik Asllani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 janarit 2013, paragrafi 45; [KI89/15](#), me parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 janarit 2015, paragrafi 35; [KI24/16](#), me parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15 shtatorit 2016, paragrafi 39; [KI30/17](#), me parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 korrikut 2017, paragrafët 35-37; dhe [KI108/18](#), me parashtruese, *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shtatorit 2019, paragrafi 154).

## 1.1 DETYRIMI I SHTERIMIT TË MJETEVE JURIDIKE NË KUPTIMIN FORMAL-PROCEDURAL

Siç është theksuar më lart, shterimi i mjeteve juridike efektive para së një kërkesë të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese, është detyrim kushtetues në kontekst të kërkesave individuale. Thënë këtë, Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, gjithashtu ka saktësuar që rregulli i shterimit të mjeteve juridike, duhet të zbatohet me një “*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*”, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI57/22](#) dhe [KI79/22](#), me parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktgjykim i 4 korrikut 2022, paragrafi 73, duke u bazuar ndër tjerash në rastet e GJEDNJ-së, *Ringeisen kundër Austrisë*, nr. 2614/65, Aktgjykim i 16 korrikut 1971, paragrafi 89; *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* [DHM] kërkesa nr. [17153/11](#) dhe 21 kërkesa të tjera, Aktgjykim, i 25 marsit 2014, paragrafi 76; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21893/93, Aktgjykim i 1 prillit 1998, paragrafi 69).



Megjithatë, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata gjithashtu ka saktësuar që në aplikimin e këtij parimi me "*fleksibilitetin e duhur dhe mungesën e formalizmit të tepruar*", duhet të vlerësohen dhe plotësohen disa kriteret. Më saktësisht, në të gjitha rastet, kur mjetet juridike nuk janë shteruar, për të përcaktuar nëse të njëjtat, në rrethanat e rasteve përkatëse, nuk do të ishin "*efektive*", duhet të vlerësohet nëse (i) ekzistenca e mjeteve juridike është "*mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*" sepse të njëjtat, duhet të jenë në gjendje "*të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi*" dhe "*të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses*"; dhe (ii) mjetet juridike përkatëse janë në "*dispozicion, të qasshme dhe efektive*", karakteristika këto të cilat duhet të jenë mjaftueshëm të konsoliduara në praktikën gjyqësore (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [K157/22](#) dhe [K179/22](#), me parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 74 dhe [K1211/19](#), me parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I. dhe S.R.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 56-57; dhe rastet e GJEDNJ-së [Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 21893/93, Aktgjykim, i 1 prillit 1998, paragrafi 69; [Öcalan kundër Turqisë](#), nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafët 63-72; dhe [Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës](#), nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafët 155-162).

Në vlerësimin e kriterëve të lartcekura, Gjykata duke marrë parasysh parimin e vlerësimit fleksibil të shterimit të mjeteve juridike dhe përshtatjen e këtij vlerësimi "*rrethanave të veçanta*" të secilit rast veç e veç, i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që ndërlidhet me "*barrën e të provuarit*". Sipas kësaj të fundit, në kontekst të GJEDNJ-së, shpërndarja e barrës së të provuarit ndahet midis parashtruesit të kërkesës dhe qeverisë përkatëse që pretendon mos-shterimin (shih, në lidhje me "*shpërndarjen e barrës së provës*", ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: [Selmouni kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 76; [Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 68). Në parim, pas pretendimeve të parashtruesit përkatës për mungesë të mjetit juridik, pala kundërshtare, përkatësisht shteti përkatës në kontekst të GJEDNJ-së, bartë barrën e të provuarit se ekziston një mjet juridik që nuk është përdorur dhe i cili është "*efektiv*", dhe vetëm pas kësaj, parashtruesi më tej do të duhet të argumentojnë të kundërtën, përkatësisht se (i) mjeti juridik i përcaktuar me ligj është shteruar; (ii) për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e rastit përkatës; ose (iii) kanë ekzistuar rrethana të cilat atë e lirojnë nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Vučković dhe Të Tjerët kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafi 74; [Mocanu dhe Të Tjerët kundër Rumanisë](#), kërkesat nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim, i 17 shtatorit 2014, paragrafi 225; dhe [Molla Sali kundër Greqisë](#), kërkesa nr. 20452/14, Aktgjykim, i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 89; dhe rastin e Gjykatës K1108/18, me parashtruese *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafi 161).

Për më tepër, parashtruesit e kërkesës duhet të dëshmojnë se "*ata kanë bërë gjithçka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*" ose parashtruesit duhet të dëshmojnë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion e të cilin ata nuk e kanë shfrytëzuar, do të dështonte. Për më tepër, "*dyshimet e thjeshta*" të një parashtruesi rreth joefikasitetit të një mjeti juridik, nuk vlejnë si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike (shih, rastet e Gjykatës K157/22 dhe K179/22, me parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, i cituar më lart, paragrafi 76; K1108/18, me parashtruese, *Blerta Morina*, i cituar më lart, paragrafi 154; dhe rastin e GJEDNJ-së [D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 116). Në kontekst të "*dyshimeve të thjeshta*", duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka sqaruar që pretendimet për ngarkesën me lëndë në gjykata të rregullta dhe/ose ato që ndërlidhen me tejzgjatjen e mundshme të procedurave përkatëse gjyqësore, nuk mund të shërbejnë si argument për ta liruar një parashtrues nga detyrimi kushtetuese për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.

Në fund, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, vlerësimi fleksibil i karakteristikave të nevojshme të mjetit juridik, duhet të bëhet duke marrë parasysh edhe rrethanat e veçanta të secilit rast individual. Në bërjen e këtij vlerësimi, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, merr parasysh edhe (i) kontekstin e përgjithshëm "*ligjor dhe politik*"; dhe (ii) "*rrethanat e veçanta/individuale*" të një parashtruesi (lidhur me shqyrtimin e kontekstit të përgjithshëm "*ligjor dhe politik*", ndër tjerash, shih, rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 68-69 dhe rastin e Gjykatës KI108/18, me parashtruese *Blerta Morina*, i cituar më lart, paragrafët 148 deri më 193). Gjykata, në rastin KI108/18, refuzoi kërkesën si të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike edhe pse kërkesa për lirim nga ky detyrim ishte bazuar, ndër tjerash, në «*rrethanat të veçanta*» të një parashtruesi, duke përfshirë "*kontekstin ligjor dhe politik*" (lidhur me konceptin e "*rrethanave të veçanta*", ndër tjerash, shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së [Van Oosterwijk kundër Belgjikës](#), nr. 7654/76, Aktgjykim i 6 nëntorit 1980, paragrafët 36-40 dhe referencat përkatëse në të; Öcalan kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 67-68 dhe referencat në të).

### 1.1.1 Lirimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike në kuptimin formal-procedural

Përgjatë gjithë praktikës së saj gjyqësore, që nga themelimi i saj, Gjykata ka bërë përjashtim nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike në gjithsej në gjashtë (6) raste, përkatësisht, (i) [KI56/09](#), me parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010; (ii) [KI06/10](#), me parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010; (iii) [KI99/14](#) dhe [KI100/14](#), me parashtrues *Shyqri Sylja dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 3 korrikut 2014; (iv) [KI34/17](#), me parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017; dhe (v) [KI55/17](#), me parashtruese *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017. Tri rastet e fundit, ndërlidhen me vlerësimin e kushtetutshmërisë së propozimit të Kryeprokurorit të Shtetit në vitin 2014 dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit në vitin 2017, nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, respektivisht. Në këto tri raste, në rrethanat specifike të secilit prej tyre, ishte vlerësuar që mjeteve efektive të përcaktuara në ligjet e aplikueshme për konfliktin administrativ, nuk ishte efektive në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së përzgjedhjes dhe/ose propozimit të tri pozitave të lartcekura (shih, rastet e Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14, me parashtrues *Shyqri Sylja dhe Laura Pula*, i cituar më lart; KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, i cituar më lart; dhe KI55/17, me parashtruese *Tonka Berisha*, i cituar më lart). Për dallim, në të gjitha rastet tjera, kur para Gjykatës ishin kontestuar procedurat e përzgjedhjes/propozimit dhe/ose emërimit të funksionarëve të lartë publikë nga institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë dy Këshillat e lartcekur, ishte vlerësuar se mjeteve juridike të përcaktuara në ligjet e aplikueshme për konfliktin administrativ ishte efektive, dhe rrjedhimisht të njëjtat ishin shpallur të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve efektive juridike të përcaktuara me ligj (shih, rastet e Gjykatës [KI114/10](#), me parashtruese *Vahide Badivuku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 qershorit 2011; [KI139/11](#), me parashtrues *Ali Latifi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 marsit 2012; [KI164/20](#), me parashtrues *Rafet Haxhaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI211/19](#), me parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R.*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020; dhe [KI74/21](#), me parashtrues *Halim Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 tetorit 2022).

Praktika gjyqësore e Gjykatës, në kontekst të detyrimit të shterimit të mjeteve efektive juridike edhe në kontekst të përzgjedhjes/propozimit dhe/ose emërimit në funksione shtetërore, është sqaruar përfundimisht përmes Aktvendimit për Papranueshmëri të 4 korrikut 2022, në rastet [KI57/22](#) dhe [KI79/22](#).

Përtej përjashtimeve të lartcekura, por në kontekst krejtësisht të ndryshëm, përkatësisht në vlerësimin e pretendimeve për shkelje të së drejtës për jetën të garantuar përmes nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 2 (E drejta për jetën) të KEDNJ-së, Gjykata, ka vlerësuar që aktualisht

në rendin juridik të Republikës së Kosovës, nuk ekziston mjet efektiv juridik për të kontestuar cenimin e të drejtave të lartcekura kushtetuese dhe rrjedhimisht, i ka liruar parashtruesit përkatës nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, duke vlerësuar meritat e kërkesave përkatëse (shih, rastin [KI41/12](#), me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013, i cituar më lart; dhe [KI129/21](#), me parashtruese *Velerda Sopi*, i cituar më lart, paragrafët 117-121).

Më tej dhe në kontekst të detyrimit për shterimin e mjeteve juridike në aspektin formal-procedural, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, janë relevante edhe dy kategori çështjesh, përkatësisht, (i) ekzistenca e disa mjeteve juridike dhe mjetet juridike në diskrecionin e një autoriteti tjetër; dhe (ii) kërkesat e parakohshme, sipas sqarimeve në vijim.

### 1.1.2 Ekzistenca e disa mjeteve juridike dhe mjetet juridike në diskrecionin e një autoriteti tjetër

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës, gjithashtu janë sqaruar rrethanat në të cilat (i) ekziston më shumë se një mjet juridik në dispozicion; dhe (ii) ushtrimi i mjetit përkatës juridik është në diskrecion të një autoriteti tjetër. Më saktësisht dhe në kontekst të çështjes së parë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është sqaruar se në rast se mund të ketë më shumë mjete juridike në dispozicion, kërkohet që parashtruesi të ketë shfrytëzuar njërin prej tyre (shih, rastet e GJEDNJ-së [Moreira Barbosa kundër Portugalisë](#), nr.65681/01, Vendim i 29 prillit 2004; [Jeličić kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), nr. 41183/02, Vendim mbi Pranueshmërinë i 15 nëntorit 2005; [Karakó kundër Hungarisë](#), nr. 39311/05, Aktgjykim i 28 prillit 2009, paragrafi 14; dhe [Aquilina kundër Maltës](#), nr. 25642/94, Aktgjykim i 29 prillit 1999, paragrafi 39). Ndërsa në kontekst të çështjes së dytë, është sqaruar që një mjet juridik nuk konsiderohet efektiv kur i njëjti nuk është drejtpërdrejtë në dispozicion të parashtruesit, por varet nga ushtrimi i diskrecionit të një institucioni tjetër, duke sqaruar, ndër tjerash, që mjeti juridik i propozimit për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Prokurorit të Shtetit, nuk është drejtpërdrejtë i qasshëm për parashtruesin e kërkesës dhe është në diskrecionin e Prokurorit të Shtetit për të vazhduar me ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, dhe për pasojë, shterimi i këtij mjeti nuk është i detyrueshëm (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI143/19](#), me parashtrues *Agim Thaqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2020; [KI234/21](#), me parashtrues *N.P.N Çlirimi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 qershorit 2022; [KI111/21](#), me parashtrues *Shaban Murati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 prillit 2023; [KI111/22](#), me parashtrues *Bechtel Enka G.P.O.P*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2023; dhe [KI174/20](#), me parashtrues, *DE-KO Sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021).

### 1.1.3 Kërkesat e parakohshme

Nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, atëherë kërkesa e parashtruesit do të konsiderohet e parakohshme (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI102/16](#), me parashtrues *Shfaqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 dhjetor 2016, paragrafi 37-39; [KI15/16](#), me parashtrues *Ramadan Muja*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016, paragrafët 38-44; [KI09/19](#), me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafët 40-43; dhe [KI49/22](#), me parashtrues *Zejnë Ninaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gusht 2023, paragrafi 59). Në këtë mënyrë, duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të referohet në Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër, vendimi përmes të cilit Gjykata, kërkesën e parashtruesit e shpallë të papranueshme për shkak se e njëjta vlerësohet si e parakohshme, nuk e pengon të njëjtin që në të ardhmen, pasi të shterojë mjetet efektive juridike, të parashtrorë përsëri kërkesën individuale në Gjykatë.



## 1.2 DETYRIMI I SHTERIMIT TË MJETEVE JURIDIKE NË KUPTIMIN SUBSTANCIAL

Shterimi i mjeteve juridike përveç detyrimit të shterimit të mjeteve juridike në kuptimin formal-procedural, ngërthen edhe detyrimin për shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë/përmbajtje*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet, pra në kuptimin formal-procedural dhe në atë substancial (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI71/22](#), me parashtrues *Muhamet Mehmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 14 nëntorit 2023, paragrafët 53-57; [KI71/18](#), me parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, i cituar më lart, paragrafi 57; [KI119/17](#), me parashtrues *Gentian Rexhepi*, i cituar më lart, paragrafi 73; [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, i cituar më lart, paragrafi 94; dhe [KI163/18](#), me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 61).

Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet përkatëse nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykata të rregullta (shih, ndër të tjerash, rastet e Gjykatës, [KI71/22](#), me parashtrues *Muhamet Mehmeti*, cituar më lart, paragrafët 56-57; [KI119/17](#), me parashtrues *Gentian Rexhepi*, i cituar më lart, paragrafi 71; [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, i cituar më lart, paragrafi 92; [KI155/18](#), me parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019; paragrafi 50; [KI163/18](#), me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 59; dhe [KI40/20](#), me parashtrues *Sadik Gashi*, i cituar më lart, paragrafët 66-69).

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, edhe nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur ndonjë nen specifik të Kushtetutës nga Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], të paktën është dashur të ngritë argumente me efekt të ngjashëm ose të njëjtë pranë gjykatave të rregullta (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI40/20](#), me parashtrues *Sadik Gashi*, i cituar më lart, paragrafi 68, dhe rastet e GJEDNJ-së [Gäfgen kundër Gjermanisë](#), nr. 22978/05, Aktgjykim, i 1 qershorit 2010, paragrafët 142, 144 dhe 146; [Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë](#), nr. 37685/10 dhe 22768/12, Aktgjykim, i 20 marsit 2018, paragrafi 117; dhe [Karapanagiotou dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 1571/08, Aktgjykim i 28 tetorit 2010, paragrafi 29).

## IV. AFATI KATËRMUJOR

### Neni 49 (Afatet) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese

*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.*

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (c) i Rregullores së Punës

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(c) Kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit...*

*[...]*

## 1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E AFATIT (4) MUJOR PËR PARASHTRIMIN E KËRKESAVE

Bazuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nënparagrafin (c) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, individët, mund të ngrenë shkeljet e pretenduara kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit katër (4) mujor. Qëllimi i këtij rregulli është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe që vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [Kl61/23](#), me parashtrues, *Hedie Bylykbashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 majit 2023, paragrafi 33; [Kl24/23](#), me parashtrues, *Sami Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 prillit 2023, paragrafi 21; [Kl44/22](#), me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri, paragrafi 48; [Kl 144/22](#), me parashtrues, *Sebahate Dërvishi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 shtatorit 2022, paragrafi 54; dhe [Kl48/21](#), me parashtrues, *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; dhe rastin e GJEDNJ-së *Lekić kundër Sllovenisë*, nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 64).

Për më tepër, afati prej katër (4) muajve, për parashtrimin e kërkesës nga individët, (i) i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe nëse po, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur; dhe në të njëjtën kohë, (ii) lehtëson vërtetimin e fakteve në një rast, duke marrë parasysh që me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura mund të vështirësohet. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë, nuk është më i mundur (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [Kl115/20](#), me parashtrues *Muharrem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, 3 nëntorit 2021, paragrafët 55 dhe 56).

Në parim, janë dy kushte parësore bazuar në të cilat llogaritet rrjedha e afatit katër (4) mujor, përkatësisht, (i) nëse vendimi i kontestuar është “vendim përfundimtar”; dhe (ii) nëse i njëjti është rezultat i mjetit të fundit efektiv juridik (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës KI44/22, cituar më lart, paragrafi 40). Në vijim, do të sqarohet praktika relevante gjyqësore për vlerësimin e këtyre dy kriterëve.

## 1.1 VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Në kontekst të vlerësimit të “vendimit përfundimtar”, Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, ka theksuar, ndër tjerash, që “afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultati shterjes se mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korrigjimin e çështjes, që është objekti ankesës.” Në kontekstin e lartcekur, ndër tjerash, është relevante, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe e Gjykatës, lidhur me (i) pikënisjen dhe përfundimin e rrjedhjes së afatit, përfshirë momentin e njoftimit të palës lidhur me vendimin përkatës; dhe (ii) kthimi në gjendjen e mëparshme.

### 1.1.1 Fillimi dhe përfundimi i afatit katër (4) mujor

Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, afati 4 (katër) mujor, fillon të rrjedhë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar parashtruesit të kërkesës apo përfaqësuesit të tij ligjor, i cili është rezultat i shterimit të mjeteve juridike efektive në rastin që është objekt i ankesës (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI59/18](#), me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 mars 2019, paragrafët 50 dhe 51). Thënë këtë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, afati gjithnjë llogaritet duke marrë për bazë rrethanat konkrete të secilit rast dhe për pasojë, i njëjti është autonom dhe zbatohet për faktet e secilit rast individualisht (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI07/23](#), me parashtrues *Musli Morina*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2023, paragrafi 32).

Për më tepër, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se periudha prej katër (4) muajsh fillon të rrjedhë nga data kur parashtruesi i kërkesës dhe/ose përfaqësuesi i tij apo i saj, e ka pranuar vendimin përfundimtar (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI45/21](#), me parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021, paragrafi 32; dhe [KI61/23](#), me parashtruese *Hedie Bylykbashi*, i cituar më lart, paragrafi 26). Kjo vlen edhe në rastet kur asnjë mjet juridik nuk është i disponueshëm apo vlerësohet/argumentohet që mjetet përkatëse juridike nuk janë efektive dhe/ose adekuate (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI59/18](#), me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 marsit 2019, paragrafët 48-52).

Për qëllime të llogaritjes së afatit, Gjykata, si rregull, vlerëson datën e njoftimit/pranimit të parashtruesit të kërkesës dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor, me vendimin përkatës përfundimtar. Data e pranimit të vendimit nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe/ose përfaqësuesit ligjor, mund të vërtetohet nga fletë-kthesa e dorëzuar në Gjykatë (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI143/19](#), me parashtrues *Agim Thaqi*, cituar më lart, paragrafi 43). Në rast, kur parashtruesi i kërkesës në lidhje me vendimin është njoftuar nga përfaqësuesi i tij, atëherë periudha e llogaritjes së afatit fillon prej momentit kur përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës është vënë në dijeni për vendimin e fundit në procesin e shterimit të mjeteve juridike, pavarësisht faktit se parashtruesi, për vendimin e lartpërmendur, është vënë në dijeni në një fazë të mëvonshme (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Çelik kundër Turqisë](#), nr. 52991/99, Vendim, i 23 shtatorit 2004). Më saktësisht, Gjykata merr për bazë datën kur parashtruesi i kërkesës/përfaqësuesi ligjor e ka pranuar vendimin përkatës nga gjykata, dhe jo datën, kur gjykata ka vendosur në lidhje me rastin (shih, rastin e Gjykatës, [KI144/22](#), me parashtruese *Sebahate Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 52).

Në anën tjetër, për qëllime të llogaritjes së afatit katër (4) mujor merret për bazë data e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë. Në këtë rast, si datë e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë merret për bazë (i) data kur parashtruesi i kërkesës personalisht ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë; (ii) data kur parashtruesi e ka dërguar kërkesën përmes postës elektronike; apo (iii) data kur parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij/saj përmes postës (shih, rastet e Gjykatës KI45/21, cituar më lart, paragrafi 6 dhe 34; dhe [KI218/19](#), me parashtrues *Shani Morina*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 6, 8 dhe 37).

Nëse tentativat për dorëzimin e vendimit të gjykatës parashtruesit të kërkesës, nuk kanë qenë të suksesshme dhe për pasojë, vendimi është shpallur në tabelën e shpalljes në gjykatën e rregullt, data e njoftimit të parashtruesit të kërkesës konsiderohet dita e fundit kur vendimi është shpallur në tabelën e shpalljeve (shih, rastin e Gjykatës [KI53/18](#), me parashtrues *Hajri Ramadani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 nëntorit 2018, paragrafët 34-42). Përrjashtimisht, afati përkatës duhet të llogaritet nga momenti kur parashtruesi i kërkesës ka pasur dijeni të mjaftueshme për vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta (shih, rastin e Gjykatës, KI 45/21, me parashtrues *Samedin Bytyqi*, i cituar më lart, paragrafi 32).

Në parim, afati katër (4) mujor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, përfundon sipas përcaktimeve të rregullit 29 (Llogaritja e periudhës kohore) të Rregullores së punës, përkatësisht (i) *“me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore”*; ndërsa (ii) *“periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë feste zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj”* (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, [KI185/14](#), me parashtrues *Zoran Kolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 8 korrikut 2015, paragrafi 31).

### 1.1.2 Kthimi në gjendjen e mëparshme

Bazuar në nenin 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligji për Gjykatën Kushtetuese, nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit, ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme, me kushtin që (i) parashtruesi të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe nëse nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me ligj; dhe (ii) të arsyetojë kërkesën në fjalë.

Gjykata, përjashtimisht, ka lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme të afatit, në parim, në rrethanat e pandemisë Covid-19, përkatësisht në rastin kur kishte vlerësuar që parashtruesi i kërkesës, pa fajin e tij, nuk ka qenë në gjendje të parashtrë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, pasi që dokumentet e nevojshme për të paraqitur të njëjtën, kanë qenë të mbyllura në objektin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit *“Mitrovica”*, si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia Covid 19 (shih, rastet [KI147/20](#), [KI148/20](#), [KI149/20](#), [KI150/20](#), [KI151/20](#) dhe [KI152/20](#), me parashtrues, *Nezir Neziri dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafët 42-47). Në të kundërtën, vuajtjen e dënimit me burg, Gjykata nuk e kishte vlerësuar si arsye për ta liruar parashtruesin përkatës nga detyrimi për të dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor (shih, rastin e Gjykatës [KI 123/16](#), me parashtrues *Vullnet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 korrikut 2017, paragrafët 36 dhe 40).

## 1.2 MJETI I FUNDIT EFEKTIV JURIDIK NË LIDHJE ME VENDIMIN PËRFUNDIMTAR

Llogaritja e afateve kohore për qëllime të parashtrimit të kërkesës në Gjykatës, është gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndërlidhur me vlerësimin e shterimit të mjeteve juridike. Më saktësisht, për qëllime të llogaritjes së afateve për parashtrimin e kërkesave, është relevante të theksohet se afatit fillon të rrjedhë nga “vendimi përfundimtar” si rezultat i një mjeti efektiv juridik. Në kontekst të efektivitetit të mjetit juridik ndërlidhur me vendimin përfundimtar që mund t’i nënshtrohet vlerësimi të Gjykatës, në parim, praktika gjyqësore e Gjykatës, është sqaruar në tri kategori rastesh, përkatësisht (i) përdorimi i mjeteve juridike të palejuara/joefektive bazuar në ligjet e aplikueshme; (ii) mungesa e mjetit juridik efektiv; dhe (iii) situatat e shkeljes së vazhdueshme.

### 1.2.1 Mjetet juridike të palejuara/joefektive

Duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata gjithashtu ka theksuar se një parashtrues i kërkesës, nuk mund të përdorë mjete juridike të cilat, sipas legjislacionit të aplikueshëm, nuk janë efektive, me qëllim të zgjatjes së afatit katër (4) mujor për të parashtruar rastin para Gjykatës, si rezultat i mosparaqitjes së kërkesës në kohë ndaj “vendimit përfundimtar” gjyqësor (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI120/17](#), me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31; [KI144/22](#), me parashtrues *Sebahate Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 37; [KI234/21](#), me parashtrues, *N.P.N “Çlirimi”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 qershorit 2022, paragrafi 36 dhe [KI25/23](#), me parashtrues *Shpejtim Ahmeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 majit 2023, paragrafët 36 -40).

Për shembull, Gjykata ka shpallur kërkesat e parashtruesve përkatës të papranueshme si të pasafatshme, ndër tjerash, kur (i) ishte parashtruar kërkesë për “*korrigjim të aktgjykimit*” kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në po të njëjtin kolegji, dhe i cili, bazuar në ligjin e aplikueshëm, kishte konstatuar që mjeti përkatës juridik është i palejueshëm (shih, rastin [KI41/18](#), me parashtruese *Gordana Dončić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shtatorit 2018, paragrafi 39); (ii) ishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, pas vendimit të Gjykatës Themelore për refuzimin e kthimit në gjendje të mëparshme, ankesë kjo e cila nuk ishte e lejueshme sipas legjislacionit të aplikueshëm (shih, rastin [KI35/21](#), me parashtrues *Sulejman Mushoviq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 korrikut 2021, paragrafët 61-62); dhe (iii) ishte parashtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, në kuadër të procedurës për zbatimin e sanksionit penal, ankesë kjo e cila nuk ishte e lejueshme sipas legjislacionit të aplikueshëm (shih, rastin [KI25/23](#), me parashtrues *Shpejtim Ahmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 majit 2023, paragrafët 39-40).

Për më tepër, janë edhe dy kategori çështjesh të cilat janë relevante në kontekst të ndërlidhjes në mes shterimit të mjeteve juridike dhe rrjedhjes përkatëse të afatit, përkatësisht rastet që ndërlidhen me (i) Njoftimin e Prokurorit të Shtetit ndaj propozimit për inicim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme; dhe (ii) mjetin e jashtëzakonshëm të goditjes, përkatësisht të revizionit në rastet kur i njëjti nuk është i lejuar, bazuar në dispozitat e ligjit të aplikueshëm.

Në kontekst të çështjes së parë, Gjykata, në parim, ka theksuar që mjeti juridik i propozimit për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në procedurë civile përmes Prokurorit të Shtetit, nuk është drejtpërdrejtë i qasshëm sepse është në diskrecionin e Prokurorit të Shtetit teqe të ngritë një kërkesë të tillë ose jo në Gjykatën Supreme. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastin e GJENDJ-së [Lepojić kundër Serbisë](#), nr. 13909/05, Aktgjykim i 6 nëntorit 2007, dhe [Trajce Stojanovski kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 1431/03,



Aktgjykim i 22 tetorit 2009), kjo e fundit kishte shpallur kërkesat e papranueshme si të pasafatshme, në rastet kur të njëjtat ishin paraqitur në Gjykatë pas vendimmarrjes së Prokurorit të Shtetit lidhur me refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke sqaruar, ndër tjerash, që (i) pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga gjykatat e rregullta, asgjë nuk i kishte ndaluar parashtruesit përkatës që të parashtronjë kërkesë në Gjykatë dhe se (ii) duke marrë parasysh që mjeti përkatës juridik nuk është drejtpërdrejtë i qasshëm dhe është në diskrecion të Prokurorit të Shtetit, për qëllime të llogaritjes së afatit, “vendim përfundimtar” është vendimi përkatës i Gjykatës së Apelit (shih, në mënyrë të ngjashme edhe rastet e Gjykatës [K1143/19](#), me parashtrues *Agim Thaqi*, cituar më lart, paragrafët 40-44; [K1234/21](#), me parashtrues *N.P.N Çlirimi*, cituar më lart, paragrafët 42-56; [K1111/21](#), me parashtrues *Bechtel Enka GP. O.P.*, cituar më lart, paragrafët 34-45; dhe [K1174/20](#), me parashtrues *DE-KO Sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafët 32-51).

Megjithatë, praktika gjyqësore e Gjykatës, njeh edhe raste në të cilat është vlerësuar kushtetutshmëria e njoftimeve të Prokurorit të Shtetit, përmes të cilave nuk është pranuar kërkesa e palëve për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në dobi të tyre dhe janë shtjelluar rrethanat kur njoftimet e tilla të Prokurorit të Shtetit, përjashtimisht, mund të i nënshtrohen vlerësimit të Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës [K142/18](#), me parashtruese *Asija Muslija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, përmes të cilit ishin vlerësuar pretendimet e parashtrueses për shkelle kushtetuese ndaj Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, mbështetur edhe në rastin e GJEDNJ-së [Gorou kundër Greqisë](#) (Nr. 2), kërkesa nr.12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009.)

Ndërsa, në kontekst të çështjes së dytë, Gjykata në parim, ka theksuar se në rastet kur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit në Gjykatën Supreme është i palejuar bazuar në ligjin e aplikueshëm, i njëjti nuk mund të përdoret për qëllime të llogaritjes së afatit katër (4) mujor dhe se si “vendim përfundimtar”, duhet të llogaritet vendimi i gjykatës përkatëse kundër të cilit është paraqitur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit dhe i cili kontestohet para Gjykatës. Më saktësisht, këto rrethana, në parim, përfshijnë, rastet kur është përdorur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit në Gjykatën Supreme, përkundër që nuk është i lejuar bazuar në nenet 211 (pa titull) dhe 228 (pa titull) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, respektivisht. Për shembull, (i) në rast kur vlera e kontestit është dukshëm nën shumën e 3,000 EUR sipas nenit 211 (pa titull) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (shih, rastin e Gjykatës [K1118/20](#) me parashtrues *Selim Leka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafët 44-48; dhe/ose (ii) përkundër faktit që i njëjti nuk ishte i lejuar sipas nenit 228 (pa titull) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (shih, rastin e Gjykatës [K1161/18](#), me parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 qershorit 2019, paragrafët 30-40). Megjithatë, në rastet kur parashtruesit e kërkesës kontestojnë në mënyrë specifike para Gjykatës Aktvendimin e Gjykatës Supreme për hedhje poshtë të revizionit për shkak të vlerës së kontestit (*ratione valoris*), Gjykata do të vlerësojë pretendimet e tyre që ndërlidhen me të drejtën për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës, [K196/22](#), me parashtrues *Naser dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 45).

### 1.2.2 Mungesa e mjetit juridik efektiv në dispozicion të palës

Në rastet kur është e qartë që në fillim që parashtruesi nuk ka mjet efektiv juridik, GJEDNJ ka theksuar se afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga data (i) kur veprimi/akti i kontestuar kishte ndodhur apo ishte nxjerrë; (ii) me rastin e pranimit të vendimit të tillë; apo (iii) kur parashtruesi i kërkesës njoftohet rreth efekteve të veprimit/aktit të kontestuar, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë afektonte të drejtat e tij/saj (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Dennis dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. [76573/01](#), Vendim për pranueshmëri, i 2 korrikut 2002; [Varanva dhe të Tjerët kundër Turqisë](#), nr. 16064/90 dhe 9 të tjera, Aktgjykim, i 18 shtatorit 2009, paragrafi 157; [Aydarov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 33586/15, Vendim i 2 tetorit 2018, paragrafi 90; dhe shih, rastin e Gjykatës [K1129/21](#), me parashtruese *Velderda Sopi*, i cituar më lart, paragrafët 124-128). Rrethana të tilla përbëjnë përjashtim. Megjithatë, Gjykata tashmë ka konsoliduar praktikën e saj gjyqësore

në këtë kontekst lidhur me të drejtën për jetën, të garantuar me nenin 25 [E Drejta për Jetë] të Kushtetutës. Për shembull, Gjykata në rastin KI41/12, Gjykata kishte konstatuar shkeljen e të drejtës për jetë përmes mosveprimit të Gjykatës Komunale, pasi që kjo gjykatë me 26 prill 2010, kishte pranuar nga e ndjera kërkesën për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente dhe se e njëjta, nuk kishte pranuar asnjë vendim lidhur me këtë kërkesë. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk e zbatoi kriteret e afatit katër (4) mujor dhe të shterjes së mjeteve juridike, duke pasur parasysh rrethanat e posaçme të rastit dhe konstatoi që palët nuk kishin pasur mjete juridike në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tyre (shih, rastin e Gjykatës KI41/12, cituar më lartë, paragrafët 41-53). Ngjashëm, në rastin KI129/21, i cili gjithashtu ndërlidhet me pretendimin për shkeljen e të drejtës për jetë dhe konstatimit që parashtruesja e kërkesës nuk kishte mjete në dispozicion për të shteruar, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së [Opuz kundër Turqisë](#), nr. 33401/02, Aktgjykim i 9 qershorit 2009, paragrafët 110-112), Gjykata mori për bazë momentin kur vrasja e të ndjerës, nënës së parashtrueses së kërkesës, kishte ndodhur dhe datën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë dhe konstatoi se kërkesa ishte dorëzuar brenda afatit të përcaktuar katër (4) mujor (shih, rastin KI129/22, të cituar më lart, paragrafët 122-128).

### 1.2.3 Situata e shkeljeve të vazhdueshme

Në rrethanat kur shkelja e pretenduar kushtetuese është e vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se periudha e afati kohor fillon të llogaritet vetëm pas përfundimit të shkeljes së supozuar kushtetuese. Shembujt e situatave të vazhdueshme bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës përfshijnë kërkesat që ndërlidhen me pretendimet për (i) tejzgjatje të procedurave para gjykatave të rregullta; dhe/ose (ii) mosekzekutimin e vendimeve të autoriteteve publike. Në kontekst të kategorisë së parë të çështjeve, ndër tjerash, relevante është praktika gjyqësore e Gjykatës, në rastet (i) [KI03/22](#), me parashtrues *EPS Trgovina* (Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022, paragrafi 45); dhe (ii) [KI183/21](#), me parashtrues *Ejup Koci* (Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 marsit 2022, paragrafi 64). Ndërsa, në kontekst të kategorisë së dytë të çështjeve, ndër tjerash, relevante është praktika gjyqësore e Gjykatës, në rastet (i) [KI40/09](#), me parashtrues *Imer Ibrahim* dhe *48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, (Aktgjykim i 23 qershorit 2010, paragrafët 40 dhe 41); (ii) [KI 53/11](#), [KI 25/12](#), [KI 100/12](#) dhe [KI 49/13](#), me parashtrues, *Isa Grajqevci*, *Fehmi Ajvazi*, *Musli Nuhiu* dhe *Ramadan Imeri*, (Aktgjykim i 14 tetorit 2013, paragrafi 38); (iii) [KI 132/10](#), [KI 28/11](#), [KI 82/11](#), [KI 85/11](#), [KI 89/11](#), [KI 100/11](#), [KI 104/11](#), [KI 109/11](#), [KI 118/11](#), [KI 123/11](#), [KI 142/11](#), [KI 143/11](#), [KI 144/11](#), [KI 154/11](#), [KI 01/12](#), [KI 02/12](#) dhe [KI 14/12](#), me parashtrues *Istref Halili* dhe *16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, (Aktgjykim i 26 shtatorit 2012, paragrafi 34); (iv) [KI 138/11](#), me parashtruese *Nazife Xhafolli*, (Aktgjykim i 4 shkurtit 2014, paragrafi 40); (v) [KI90/16](#), me parashtrues *Branislav Jokić* (Aktgjykim i 5 dhjetorit 2017, paragrafët 32-35); dhe (vi) [KI 65/15](#), me parashtrues *Tatjana Davila*, *Ljubića Maric*, *Zorica Krsenković*, *Zlatoj Jevtić* (Aktgjykim i 14 shtatorit 2016, paragrafi 78).

Në fund, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, gjithashtu përcakton situata të veçanta të zbatimit të afatit katër (4) mujor, përfshirë në kushtet e (i) shkeljes së të drejtës për jetën; (ii) mungesën e një hetimi efektiv në rast të vdekjes dhe keqtrajtimit; dhe (iii) kushtet e parburgimit. Përderisa Gjykata, nuk ka praktikë relevante lidhur me dy kategoritë e fundit si më sipër, parimet dhe kushtet për llogaritjen e afatit në rrethana të tilla, mund t'i nënshtrohet përjashtimeve, kur janë të përcaktuara në praktikën relevante të GJEDNJ-së, e cila përfshinë por nuk kufizohet në rastet (i) [Melnichuk dhe të tjerët kundër Rumanisë](#) (nr.35279/10 dhe 34782/10, Aktgjykim i 5 majit 2015, paragrafët 87-89); (ii) [Sakvarelidze kundër Gjeorgjisë](#), nr. 40394/10, Aktgjykim i 6 shkurtit 2020, paragrafët 41-46); (iii) [Velev kundër Bullgarisë](#), nr. 43531/08, Aktgjykim i 16 prillit 2013, paragrafët 40, 59 dhe 60); (iv) [Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafët 265 dhe 273-275); (v) [Ananyev dhe të tjerët kundër Rusisë](#), nr. 42525/07 dhe 60800/08, Aktgjykim i 10 Janarit 2012, paragrafët 75-78); (vi) [Shishanov kundër Republikës së Moldavisë](#), nr. 11353/06, Aktgjykim i 15 Shtatorit 2015, paragrafët 68-69); dhe (vii) [Gough kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 49327/11, Aktgjykim i 28 tetorit 2014, paragrafët 133-134).

# V. MOSSAKTËSIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE NGA PARASHTRUESI I KËRKESËS

## Neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

## Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (d) i Rregullores së Punës

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përmban gjithsej dy kërkesa. E para ngërthen (i) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar nga autoriteti publik – vendimin e të cilit e kontestojnë; dhe, e dyta paraqet (ii) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që dëshirojnë ta kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese. Që të dy këto kriteret të nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e veçanërisht kriteri i parë i këtij neni, reflektohen edhe në nënparagrafin (d) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, ku kërkohet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatë, duhet të qartësojë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesë faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, [KI91/17](#), me parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31; [KI206/19](#), me parashtrues *Mladen Nikolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020; paragrafët 33-36; [KI97/20](#), me parashtrues *Nehat Salihu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 marsit 2021; [KI73/21](#), me parashtrues *Minire Krasniqi-Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2021, paragrafi 39; dhe [KI134/23](#), me parashtruese *Feride Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafët 32-33).

Sa i përket këtyre kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe më tej të specifikuar në Rregulloren të punës, Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesit e kërkesës kanë saktësuar qartë aktin e autoritetit publik të cilin e kontestojnë, nëse të njëjtit nuk e përmbushin detyrimin e tyre që të “qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se i janë cenuar” nga autoriteti publik, kërkesa përkatëse do të shpallet e papranueshme ashtu siç përcaktohet me nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese në ndërlidhje me nënparagrafin (d) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës.



# VI. PAPRANUESHMËRIA E KËRKESËS BAZUAR NË MERITA - KËRKESA QARTAZI E PABAZUAR

## Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (d) dhe (2) i Rregullores së Punës

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*

## 1. QËLLIMI/KUPTIMËSIA E SHPALLJES SË KËRKESAVE TË PAPRANUESHME SI QARTAZI TË PABAZUARA NË BAZA KUSHTETUESE

Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht, nëse e njëjta vlerëson që përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës (shih, ndër tjerash, rastet [KI26/23](#), me parashtrues *Kastrioti Petrol*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 nëntorit 2023, paragrafi 46; [KI96/22](#), me parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 52; [KI216/21](#), me parashtrues *Kujtim Reznici*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2022, paragrafi 45; [KI203/21 dhe KI205/21](#), me parashtrues *Nexhmije dhe Sahit Kabashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 9 marsit 2022, paragrafi 73; [KI175/20](#), me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafi 37).

Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’ju referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Pretendimet qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, bazuar në praktikën gjyqësore, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta”.

Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Gjykata i ka zhvilluar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por pa u kufizuar në rastet (i) KI40/20, me parashtrues *Sadik Gashi*, i cituar më lart, i 20 janarit 2021; (ii) [KI163/18](#), me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; (iii) [KI21/21](#), me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021; dhe (iv) [KI107/21](#), me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021.

## 1.1 Pretendimet e “shkallës së katërt”

Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura para saj dhe pas shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, vlerëson kushtetutshmërinë e akteve të autoriteteve publike. Më saktësisht, fushëveprimi i Gjykatës është i kufizuar vetëm në kontrollin e aktit të kontestuar në kontekst të përputhshmërisë me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, duke respektuar diskrecionin dhe kompetencën e gjykatave të rregullta për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve të kontestuara para Gjykatës. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si një gjykatë e “shkallës së katërt”, në kundërshtim me kufijtë e juridiksionit të saj kushtetues dhe do të cenonte juridiksionin e gjykatave të rregullta, siç është i përcaktuar me Kushtetutë. Për pasojë, Gjykata nuk merret me gabimet faktike ose ligjore të bëra nga gjykatat e rregullta, përveç nëse gabimet e tilla kanë rezultuar në shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.

Praktika gjyqësore e Gjykatës është tejet e konsoliduar në këtë kontekst. Nëse parashtruesit e kërkesave para Gjykatës, thjeshtë ngritin pretendime që ndërlidhen me mënyrën e interpretimit dhe/ose aplikimit të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta dhe/ose vlerësimin e provave dhe nuk parashtrojnë asnjë argument që ndërlidhet me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, Gjykata, në pajtim me doktrinën e “shkallës së katërt” dhe parimin e subsidiaritetit, do t’i shpallë ato si kërkesa të papranueshme bazuar në shqyrtimin e meritave përkatëse (shih, në këtë kontekst dhe ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), me parashtruese *Belgjyza Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafët 68-84; [KI49/19](#), me parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SHA, “Adem Jashari”*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 47; [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, i cituar më lart, paragrafi 60; [KI76/21](#), me parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi, i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34; [KI188/21](#), me parashtrues *Zenel dhe Isuf Pllashniku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafët 98-99; dhe [KI31/22](#), me parashtrues *Fidan Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 janarit 2023, paragrafët 43-44).

Në dritën e të lartcekurave, Gjykata, në parim, nuk mund të vë në pikëpyetje të gjeturat dhe konstatimet e gjykatave të rregullta që ndërlidhen me: (i) vërtetimin e gjendjes faktike të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit të aplikueshëm nga ana e gjykatave të rregullta; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave gjatë procedurës; (iv) nëse konstatimi përfundimtar në një kontest civil ka qenë i drejtë; dhe/ose (v) fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit në procedurë penale.

Megjithatë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përjashtimisht, mund të shqyrtojë çështjet që ndërlidhen me interpretimet ligjore apo gjendjen e konstatuar faktike, nëse bazuar në pretendimet e parashtruesit përkatës si dhe rrethanat specifike të rastit konkret, rezulton që konstatimet e autoriteteve publike/gjykatave të rregullta, kanë rezultuar në “konkluzione qartazi të gabueshme dhe/ose arbitrare” për parashtruesin e kërkesës, që vetvetiu do të rezultonte në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastet e Gjykatës [KI175/17](#), me parashtrues X, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 59; [KI122/16](#) me parashtrues Riza Dembogaj, Aktgjykimi, i 30 majit 2018, paragrafi 79; dhe [KI193/22](#), me parashtrues Avni Selmani, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, paragrafi 62; dhe rastet e GJEDNJ-së [Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë](#) [DHM], nr. 60654/00, Aktgjykim i 15 janarit 2007; [De Tommaso kundër Italisë](#) [DHM], nr. 43395/09, Aktgjykim, i 23 shkurtit 2017, paragrafi 170; dhe [Kononov kundër Letonisë](#) [DHM], nr. 36376/04 Aktgjykim, i 17 majit 2010, paragrafi 189).

## 1.2 Mungesa e dukshme ose evidente e shkeljes

Mungesa e dukshme dhe/ose evidente e shkeljes, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është një ndër bazat mbi të cilën një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Në raste të tilla, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës në “merita”, dhe përmes Aktvendimit për Papranueshmëri, konstaton se të njëjtat janë të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese për shkak të “mungesës së dukshme apo evidente të shkeljes”.

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, një konstatim i tillë mund të arrihet në rastet kur (i) vlerësohet që procedurat në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave ishte në tërësinë e saj e drejtë dhe nuk ishte arbitrare; (ii) vlerësohet se nëdukje, nuk ka mungesë të proporcionalitetit në mes të qëllimit dhe mjeteve të shfrytëzuara (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mentzen kundër Letonisë](#), nr. 71074/01, Vendim për Pranueshmëri i 7 dhjetorit 2004); (iii) vlerësohet se ka mungesë të dukshme të shkeljes së nenit të kontestuar të KEDNJ-së, në të cilin thirret parashtruesi, për shkak se ka praktikë gjyqësore të mjaftueshme të GJEDNJ-së në raste identike apo të ngjashme, mbi bazën e të cilave mund të konkludohet se nuk ka pasur shkelje (shih, rastin e GJEDNJ-së [Galev dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr.18324/04, Vendim për Pranueshmëri i 29 shtatorit 2009); ose (iv) megjithëse nuk ka praktikë gjyqësore të ngjashme ose identike, mund të arrihet tek një përfundim i tillë në bazë të praktikës ekzistuese gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Hartung kundër Francës](#), nr. 10232/07, Vendim për Pranueshmëri i 3 nëntorit 2009).

Duke aplikuar parimet e lartcekura që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, një qasje të tillë, Gjykata e ka aplikuar, ndër tjerash, në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për (i) interpretim dhe zbatim arbitrar të ligjit nga gjykatat e rregullta (shih, rastin [KI111/21](#) me parashtrues Shaban Murati, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 prillit 2023, paragrafët 80-81); (ii) mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor (shih, ndër tjerash, rastet [KI40/20](#) me parashtrues Sadik Gashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafët 61-62; [KI188/21](#), me parashtrues Zenel dhe Isuf Pllashniku, Aktvendim për Papranueshmëri, i cituar më lart, paragrafët 89-90; dhe [KI208/23](#), me parashtrues Telekom i Kosovës Sh.A, Aktvendim për Papranueshmëri, i 31 janarit 2024, paragrafët 57-66); (iii) për tejzgjatje të procedurës gjyqësore (shih rastin [KI183/21](#), me parashtrues Ejup Koci, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 marsit 2022, paragrafët 114-115); (iv) barazinë e armëve (shih, rastin [KI89/22](#), me parashtrues Xhelal Plakolli, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 marsit 2023, paragrafët 57-69) dhe (iv) divergjencën në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta (shih, ndër tjerash, rastin [KI57/23](#), me parashtrues Ismet Ferati, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, paragrafët 42-55).

### 1.3 Pretendimet e “pambështetura dhe paarsyetuara”

Siç është sqaruar më lart, bazuar në nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë. Përmë tepër, bazuar në nënparagrafin (d) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, një kërkesë e dorëzuar para Gjykatës, duhet që saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqes faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Nëse ky nuk është rasti, Gjykata shpallë një kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, për shkak se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, janë të “pambështetura dhe të paarsyetuara” (shih, rastet e Gjykatës [K1160/20](#), me parashtrues, *Komuna e Gjilanit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 majit 2022, paragrafi 121; [K108/21](#), me parashtrues *Mirishahe Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 qershorit 2021, paragrafët 61-62; dhe [K170/21](#), me parashtrues *Burhan Tusha*, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 qershorit 2021, paragrafët 59-60).

Shumica e rasteve para Gjykatës që janë shpallur të papranueshme mbi bazën e lartcekur, reflektojnë raste në të cilat, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e dorëzuar para Gjykatës, thjeshtë ka përmendur apo cituar ndonjë nen të Kushtetutës, pa shpjeguar se si i njëjti është shkelur në rastin e tij (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [K1126/22](#), me parashtrues *Gëzim Bajrami*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2023, paragrafët 86-87; [K1119/21](#), me parashtrues *Ahmet Hoti dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 qershorit 2022, paragrafi 94; [K1163/18](#), me parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafët 86-87; [K102/18](#), me parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; [K1124/20](#) me parashtrues *Muhamed Ali Ceysülmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42; dhe [K195/19](#), me parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih, po ashtu rastet e GJENDJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr.4241/03, Vendim i Pjesshëm për Pranueshmëri i 31 majit 2005; [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim për Pranueshmëri i 25 shtatorit 2008).

### 1.4 PRETENDIMET “KONFUZE OSE TË PAQARTA”

Kategoria e fundit, e cila i referohet rasteve kur Gjykata mund të shpallë kërkesën si qartazi të pabazuar, përfshijnë edhe rastet kur pretendimet e parashtruara para Gjykatës janë aq “konfuze ose të paqarta” sa që është objektivisht e pamundur që Gjykata t’i japë kuptim fakteve të shpjeguara nga parashtruesi i kërkesës dhe pretendimeve të paraqitura para saj. E njëjta, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlen edhe për pretendimet të cilat kanë të bëjnë me fakte “të cilat janë objektivisht të pamundura, qartazi janë trilluar ose janë në kundërshtim të hapur me logjikën e shëndoshë”.

# VII. BAZAT E PAPRANUESHMËRISË LIDHUR ME JURIDIKSIONIN E GJYKATËS

## 1. PAPAJTUESHMËRIA RATIONE MATERIAE

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (3) (b) i Rregullores së Punës

[...]

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

[...]

(b) Kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;

[...]

### 1.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPAJTUESHMËRISË RATIONE MATERIAE ME KUSHTETUTËN

Pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën, buron nga juridiksioni material ose lëndor i Gjykatës. Kjo nënkupton që në mënyrë që një kërkesë të shpallet si *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, e drejta apo liria individuale, në të cilën referohet parashtruesi i kërkesës, përkatësisht e drejta që pretendon t'i jetë shkelur duhet të jetë e drejtë dhe liri individuale e garantuar me Kushtetutë. Për më tepër, pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkesë, ndërlidhet me fushëveprimin e neneve specifike të Kushtetutës apo të instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës bazuar në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, pretendimi që ngritë parashtruesi i kërkesës, duhet të hyjë në fushëveprimin e të drejtës konkrete të garantuar me Kushtetutë, në mënyrë që e njëjta të konsiderohet *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka theksuar se pajtueshmëria *ratione materiae*, duhet të shqyrtohet gjatë secilës fazë të shqyrtimit të një kërkesë individuale (shih, rastin e Gjykatës [KI63/15](#), me parashtrues *Bedri Haxhi Halili*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015, paragrafi 16; dhe [KI138/14](#), me parashtrues *Majda Fazli-Neziri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2014, paragrafi 15). Me rastin e shqyrtimit të pajtueshmërisë *ratione materiae* me Kushtetutën, Gjykata, në parim, vlerëson nëse (i) e drejta apo liria individuale që parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jetë shkelur është e garantuar me ndonjë nga dispozitat e Kushtetutës apo instrumentet ndërkombëtare të listuara në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës; dhe (ii) çështja që ngritë parashtruesi i kërkesës në kontekst të një të drejte individuale, hyn në fushëveprimin e asaj të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë.



Më saktësisht, ndërlidhur me çështjen e parë, përkatësisht të drejtën apo lirinë individuale që parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jetë shkelur, Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka konstatuar që kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, lidhur me (i) kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, pasi në atë procedurë nuk vendoset lidhur me akuzën penale, përkatëse në kontekst të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës [KI06/18](#), me parashtrues *Shkumbin Mehmeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 53); (ii) kërkesën për interpretimin e statutit të një subjekti politik (shih, rastin e Gjykatës [KI115/12](#), me parashtrues *Fadil Salihu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2013, paragrafët 18-19); (iii) kërkesën për dhënie të mendimit lidhur me mundësinë e punësimit me titullin e fituar akademik master (shih, rastin e Gjykatës [KI138/14](#), me parashtrues *Majda Fazli-Neziri*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, paragrafët 13-16); (iv) kërkesën për interpretim ligjor të Ligjit për Prokurimin Publik (shih, rastin e Gjykatës [KI15/15](#), me parashtrues *Hysni Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 korrikut 2015, paragrafi 24); dhe (v) kërkesën për vlerësimin e vendimeve të gjykatave të rregullta ndërlidhur me konteste nga marrëdhënia e punës me konfesionet fetare, përkatësisht Bashkësinë Islame të Kosovës, në kuadër të së cilës, gjithashtu Gjykata sqaroi rrethanat kur garancitë e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, janë të aplikueshme në rast të kontesteve të ndërlidhura me konfesionet fetare (shih, rastin e Gjykatës [KI133/17](#), me parashtrues *Ali Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafët 53-71). Për më tepër, dhe përpos që e drejta që pretendohet të jetë shkelur duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë, në mënyrë që një kërkesë të shpallet si *ratione materiae* në pajtueshmëri me Kushtetutën, ajo po ashtu duhet të bie brenda juridiksionit të Gjykatës. Gjykata e vlerësoi një kërkesë si të papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën për faktin se nuk ishte brenda juridiksionit të saj që të vlerësojë përputhshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare (shih, rastin e Gjykatës [KI168/14](#), me parashtrues *Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 gushtit 2015, paragrafi 57).

Ndërsa, ndërlidhur me çështjen e dytë, përkatësisht nëse pretendimi për shkelje të një të drejte apo lirie individuale hyn në fushëveprimin e një të drejte apo lirie individuale, praktika gjyqësore e Gjykatës, mund të kategorizohet në tri grupet si në vijim, përkatësisht nëse (i) vendimet gjyqësore për refuzimin e kërkesave për rishikim apo ripërsëritje të procedurës; (ii) vendimet gjyqësore të nxjerra në kuadër të "*procedurës paraprake*", përkatësisht procedurat që ndërlidhen me masën e sigurimit në procedurë civile apo të kërkesës për pezullim të vendimit administrativ në procedurë administrative; dhe (iii) vendimet gjyqësore në lidhje me akuzën penale të ngritur ndaj personit të tretë; kanë rezultuar në cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të KEDNJ-së. Secila prej këtyre kategorive është shtjelluar në vijim.

### 1.1.1 Rishikimi dhe ripërsëritja e procedurës

Në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore që ndërlidhen me rishikimin apo ripërsëritjen e procedurës gjyqësore, Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, dhe duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka konstatuar që neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së, nuk zbatohen në procedurat, përmes të cilave kërkohet rishikimi apo ripërsëritja e procedurës, as në procedurë civile edhe as në atë penale. Për pasojë, kërkesat për vlerësimin e vendimeve gjyqësore për refuzimin e kërkesës për rishikimin apo ripërsëritjen e procedurës, në parim, Gjykata i ka shpallur, si *ratione materiae* të papajtueshme me Kushtetutën.

Në kontekst të procedurës penale, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka sqaruar që, në parim, një person, dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit përkatës, (i) nuk është më tej i “akuzuar për vepër penale” brenda kuptimit të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (ii) në procedurën sipas kërkesës për rishikim të procedurës penale, gjykatat e rregullta, vendosin vetëm nëse kërkesa për rishikim të procedurës penale plotëson kushtet procedurale për miratimin e saj dhe jo për “ndonjë aktakuzë” të parashtruesit të kërkesës, në kontekst të fushëveprimit të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [K107/17](#), me parashtrues *Pashk Mirashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 majit 2017, paragrafi 66; [K106/18](#), me parashtrues *Shkumbin Mehmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 55; [K150/18](#), me parashtrues *Deljalj Kazagić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 51; [K176/18](#), me parashtrues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 69; dhe [K134/23](#), me parashtrues *Veton Sylja*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafët 48 dhe 49).

Ndërsa, në kontekst të procedurës civile, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka sqaruar që, në parim, Kushtetuta nuk garanton të drejtën për ripërsëritje të procedurës, përderisa dhe për aq sa gjatë kësaj procedure, gjykatat e rregullta nuk vendosin përkitazi me “të drejtat civile” të parashtruesit përkatës të kërkesës, marrë parasysh që të njëjtat, përkatësisht “të drejtat civile”, tashmë janë vendosur me një vendim të formës së prerë (shih, rastet e Gjykatës [K180/15](#), [K181/15](#) dhe [K182/15](#), me parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016, paragrafi 33; dhe [K163/21](#), me parashtrues *Hysen Metahysa*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 tetorit 2021, paragrafët 76). Thënë këtë, në rastet kur gjykatat e rregullta, kanë vendosur për miratimin e rishikimit dhe ripërsëritjes së procedurës, si në procedurë penale dhe në atë civile, të një procedure të përfunduar me vendim të formës së prerë, garancitë e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së, fillojnë të gjejnë zbatim.

Marrë parasysh që praktika gjyqësore e Gjykatës nuk është ende e konsoliduar në kontekst të përjashtimeve, përkatësisht aplikueshmërisë së garancive të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së në ndërlidhje me procedurën për rishikim apo ripërsëritje të procedurës, disa shembuj të rasteve të GJEDNJ-së në këtë aspekt, përfshijnë si në vijim: (i) në kuadër të vendimeve të nxjerra në lidhje me kërkesën për rihapje të procedurës penale, garancitë e nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së, gjejnë zbatim kur mjeti i jashtëzakonshëm juridik për rihapje të procedurës ngërthen detyrimin e gjykatave që të vendosin në lidhje me akuzën penale (shih, rastin e GJEDNJ-së [Moreira Ferreira kundër Portugalisë](#) (nr.2), nr. 19867/12, Aktgjykim, i 11 korrikut 2017, paragrafi 65); dhe (ii) në kuadër të procedurës civile, fushëveprimi dhe veçoritë specifike të një ankese të jashtëzakonshme në një sistem ligjor specifik, mund të jenë të një natyre të tillë që procedura e ndjekur sipas saj mund të hyjë në fushëveprimin e nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe garancitë e një procesi të drejtë që i ofrohet palëve ndërgjyqëse (shih, rastin e GJEDNJ-së [Bochan kundër Ukrainës](#) (nr.2), nr. 22251/08, Aktgjykim, i 5 shkurtit 2015, paragrafi 50).

## 1.1.2 Procedurat paraprake

Për më tepër, në parim, vendimet e nxjerra në procedurë paraprake në kuadër të masave të përkohshme apo atyre të sigurisë, në një kontest civil, janë *ratione materiae* në papajtueshmëri me Kushtetutën, përveç në rastet kur vet masa e përkohshme dhe/apo e sigurisë, ndërlidhet me “*të drejtën civile në fjalë*”. Për pasojë dhe në kuadër të vlerësimit të vendimeve gjyqësore të nxjerra në procedurë paraprake, përkatësisht në kuptim të kërkesave për caktimin e masës së përkohshme/të sigurimit apo pezullimit të ekzekutimit të vendimit administrativ, Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, para vlerësimit të pretendimeve të ngritura të parashtruesit përkatës për shkelje të së drejtës së tij/saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, fillimisht vlerëson nëse neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, janë të aplikueshëm në rrethanat e rastit përkatës. Kjo për faktin se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, jo të gjitha masat e përkohshme dhe/ose të sigurisë përcaktojnë “*të drejta dhe detyrime civile*”. Në këtë kontekst dhe duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, praktika gjyqësore e Gjykatës ka përcaktuar parimet që duhen marrë parasysh nëse procedurat përkatëse paraprake përcaktojnë “*të drejta dhe detyrime civile*”, përkatësisht nëse (i) e drejta në fjalë është “*civile*” në kuptim të KEDNJ-së si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (ii) kjo procedurë përcakton në mënyrë efektive të drejtën “*civile*” përkatëse. Çdo herë që një masë e përkohshme dhe/ose e sigurisë mund të konsiderohet efektive për të përcaktuar të “*drejtën civile ose detyrimin në fjalë*”, garancitë e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, janë të zbatueshme. Duke u bazuar edhe në rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës* (nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 84 dhe 85 dhe referencat e përmendura aty), Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore në këto raste, të cilat, ndër tjerash, përfshijnë (i) në procedurë civile rastet e Gjykatës [KI 122/17](#), me parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim i 18 prillit 2018, paragrafët 125-135; [KI150/16](#) me parashtrues, *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafët 62-72; [KI81/19](#), me parashtrues *Skënder Podrimqaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 nëntorit 2019, paragrafët 38-51; dhe [KI107/19](#), me parashtrues, *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafët 48-59; ndërsa (ii) në procedurë administrative rastet e Gjykatës [KI195/20](#), me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021, paragrafët 73-85, [KI202/21](#), me parashtrues *Kelkos Energy SH.P.K.*, Aktgjykim, i 29 shtatorit 2022, paragrafët 91-101; dhe [KI143/22](#), me parashtrues *Hidroenergji SHPK*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafët 98-108.

## 1.1.3 Akuza penale e ngritur ndaj personit të tretë

Në lidhje me kërkesat përmes të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij/saj si pasojë e akuzës penale e cila nuk është ngritur kundër tij/saj, por kundër personit të tretë, Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka konstatuar që kërkesa të tilla, nuk hyjnë brenda fushëveprimit të 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse rrethanat e tilla, nuk ndërlidhen me “*cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij*” sipas përcaktimit të Kushtetutës, përveç nëse një procedurë e tillë vendosë edhe në raport me të drejtat e tyre civile, përfshirë kërkesën pasurore-juridike. Për më tepër dhe në kontekstin e lartcekur, Gjykata ka theksuar që Kushtetuta dhe KEDNJ, ndër tjerash, “*nuk sigurojnë të drejtën e ndjekjes ose dënimit të një pale të tretë për një vepër penale*.” (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI52/18](#), me parashtrues *Zoran Stanišić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafët 48-53; [KI15/21](#), me parashtrues *Bersim Sulja*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 korrikut 2021, paragrafët 56-57; [KI90/18](#), me parashtrues *Nedvedete Ponosheci dhe Atdhe Ponosheci*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15



janarit 2020, paragrafi 57; [KI174/18](#), me parashtrues *Bedri Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 prillit 2019, paragrafi 31; dhe [KI77/20](#), me parashtrues *Kujtim Zarari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 43-46.

Në fund dhe në kontekst të papajtueshmërisë *ratione materie* me Kushtetutën, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata nuk është e obliguar që të shqyrtojë pretendimet për të drejta dhe liri themelore të tjera të garantuara me instrumente të ndryshme ndërkombëtare dhe të cilat nuk janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Megjithatë, sipas praktikës së lartcekur gjyqësore, në ato raste kur e drejta apo liria përkatëse mund të përkufizohet në kuptimin e termave apo nocioneve të Kushtetutës dhe/ose KEDNJ-së, “mund dhe duhet të marrë për bazë elementet e të drejtës ndërkombëtare, të tjera nga ato të Konventës, interpretimi i elementeve të tilla nga organet kompetente, dhe praktikën e shteteve evropiane që reflektojnë vlerat e tyre të përbashkëta” (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Demir dhe Baykara kundër Turqisë](#), nr.34503/97, Aktgjykim i datës 12 nëntor 2018, paragrafi 85).

---

## 2. PAPAJTUESHMËRIA RATIONE PERSONAE

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (3) (c) i Rregullores së punës

[...]

(3)Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

[...]

(c) Kërkesa nuk është *ratione personae* në pajtim me Kushtetutën;

[...]

### 2.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPAJTUESHMËRISË RATIONE PERSONAE ME KUSHTETUTËN

Pajtueshmëria *ratione personae* e kërkesës me Kushtetutën, në parim, nënkupton që shkeljet e pretenduara kushtetuese duhet të jenë kryer nga një autoritet publik i Republikës së Kosovës (shih, rastin e Gjykatës [KI63/09](#), me parashtrues *Bajram Santuri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 korrikut 2011, paragrafët 49-50). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përputhshmëria *ratione personae* e kërkesës duhet të trajtohet sipas detyrës zyrtare nga Gjykata (shih, rastin e GJEDNJ-së [Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Herzegovinës](#), nr.27996/06 dhe 34836/06, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 27). Kështu, Gjykata gjatë shqyrtimit të secilës kërkesë, paraprakisht do të vlerësojë nëse shkeljet e pretenduara kushtetuese janë kryer nga një autoritet publik ose jo.

Në kuptim të praktikës së GJEDNJ-së, shtrirja e juridiksionit të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, supozohet të jetë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Shtrirja e këtij juridiksioni përfshinë edhe vendimet e marra në kufi të territorit shtetëror (shih, rastin e GJEDNJ-së [M.A. dhe të tjerët kundër Lituaniës](#), nr.59793/17, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafët 69-72). Megjithatë, mungesa e juridiksionit territorial, përkatësisht *ratione loci*, nuk e liron automatikisht Gjykatën nga detyrimi për vlerësimin e ekzistimit të juridiksionit *ratione personae* (shih, rastin e GJEDNJ-së [Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës](#), nr.12747/87, Aktgjykim i 26 qershorit 1992, paragrafët 84-90). Kjo pasi në rrethana të jashtëzakonshme, në kuptim të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, mund të mbahen përgjegjës për shkeljet e supozuara përmes vendimeve të cilat prodhojnë efekte jashtë territorit të Republikës së Kosovës (shih, rastin e GJEDNJ-së [Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës](#), cituar më lartë, paragrafi 91; dhe [Loizidou kundër Turqisë](#), nr.15318/89, Aktgjykim i datës 23 mars 1995, paragrafët 59-64). Raste të njohura të ushtrimit jashtë-territorial të juridiksionit shtetëror, përfshijnë ushtrimin e autoritetit të diplomatëve dhe konsujve ndaj shtetasve të shtetit të tyre dhe pronës së tyre. Në raste të tilla, përkundër faktit që shkeljet e pretenduara kanë ndodhur jashtë territorit të shtetit, juridiksioni që shteti ka ushtruar përmes autoritetit të diplomatëve dhe konsujve përkatës, e vë atë para përgjegjësisë dhe rrjedhimisht, një kërkesë individuale do të konsiderohej *ratione personae* në përputhje me Kushtetutën, përkundër që shkelja e pretenduar ka ndodhur jashtë territorit të shtetit (shih, rastin e GJEDNJ-së [M.N. dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), nr.3599/18, Aktgjykim i 5 marsit 2020, paragrafi 106).

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, gjithashtu, ndër tjerash, saktëson edhe (i) kushtin e kompetencës së ushtrimit të juridiksionit të autoritetit përkatës publik; (ii) autoritetin përkatës të ndërmarrjeve publike; (iii) përgjegjësinë e autoritetit publik në rast të veprimeve të individëve privatë; dhe (iv) autoritetin e organizatave ndërkombëtare. Më saktësisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në kontekst të çështjes së parë, ushtrimi i juridiksionit nga një autoritet publik është një kusht i domosdoshëm që autoritetet publike të mbahen përgjegjëse për veprimet apo mosveprimet e tyre përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtave të njeriut (shih, rastin e GJEDNJ-së [Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldovës dhe Ruisisë](#), nr.48787/99, Aktgjykim i 8 korrikut 2004, paragrafi 311). Kështu, përpos atributit të “autoritetit publik” të shkelësit të supozuar të të drejtave të njeriut, juridiksioni *ratione personae* kërkon që të përcaktohet nëse një autoritet publik kishte apo jo juridiksion në çështjen konkrete. Në kontekst të çështjes së dytë, përpos autoriteteve publike, edhe shkeljet e pretenduara të një ndërmarrjeve publike, e cila funksionon si subjekt juridik në vete, mund të konsiderohen *ratione personae* në pajtim me Kushtetutën, për aq sa këtyre ndërmarrjeve u mungon pavarësia e mjaftueshme institucionale dhe operacionale që ta lirojë shtetin nga përgjegjësia (shih, rastet e GJEDNJ-së [Mykhaylenky dhe të tjerët kundër Ukrainës](#), nr.35091/02, 35196/02, 35201/02, 35204/02, 35945/02,35949/02, 35953/02, 36800/02, 38296/02, dhe 42814/02), Aktgjykim i 30 nëntorit 2004, paragrafët 43-46; dhe [Tokel kundër Turqisë](#), nr.23662/08, Aktgjykim i datës 9 shkurt 2021, paragrafët 58-63). Në rastin e Republikës së Kosovës, të tilla janë ndërmarrjet publike, të cilat përkundër subjektivitetit të pavarur juridik, janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku nga autoritetet publike zgjedhen organet drejtuese të këtyre ndërmarrjeve (shih, ndër tjerash, Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009). Në kontekst të çështjes së tretë, përkatësisht ndërlidhur me veprimet e individëve privatë, autoritetet publike mund të mbahen përgjegjëse vetëm nëse kanë pranuar apo miratuar veprimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së [Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldovës dhe Ruisisë](#), cituar më lartë, paragrafi 318). Ndërsa, në kontekst të çështjes së katërt, një shkelje e pretenduar e të drejtave të njeriut që rrjedhë nga një vendim i një organizate ndërkombëtare, nuk mund t’i atribuohet autoriteteve publike, edhe nëse shteti përkatës është anëtar i asaj organizate. Përfundimisht nga kjo përbëjnë rastet kur organizata në të cilët është anëtarësuar shteti përkatës, nuk ofron mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përgjithësisht ekuivalente me ato që ofrohen në KEDNJ (shih, rastin e GJEDNJ-së [Roland Klausecker kundër Gjermanisë](#), cituar më lartë, paragrafi 97).

Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kjo e fundit ka konstatuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në papajtueshmëri *ratione personae* me Kushtetutën në rastet kur parashtruesit e kërkesës kontestuan (i) vendimet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) (shih, rastin e Gjykatës [KI108/16](#), me parashtrues *Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, paragrafët 46-49); (ii) vendimet e GJEDNJ-së dhe disa ngjarjeve që kishin ndodhur në Suedi (shih, rastin e Gjykatës [KI63/09](#), me parashtrues *Bajram Santuri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 korrikut 2011, paragrafët 49-50); dhe (iii) Dekretin e Presidentit për falje, dhe i cili nuk afektonte në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e parashtruesit përkatës, por të personave të tjerë (shih, rastin e Gjykatës [KI67/18](#), me parashtruese *Arbenita Arifi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 14 majit 2019, paragrafi 44).

## 3. PAPAJTUESHMËRIA RATIONE TEMPORIS

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (3) (d) i Rregullores së punës

[...]

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

[...]

(d) Kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën;

[...]

### 3.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPAJTUESHMËRISË RATIONE TEMPORIS ME KUSHTETUTËN

Pajtueshmëria *ratione temporis* e kërkesës me Kushtetutën, në parim, paraqet detyrimin kohor të vet Kushtetutës dhe rrjedhimisht, edhe juridiksionin kohor të Gjykatës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008 dhe rrjedhimisht, në mënyrë që një kërkesë të konsiderohet si *ratione temporis* e pajtueshme me Kushtetutë, shkeljet e pretenduara duhet të kenë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Autoritetet publike mund të mbahen përgjegjëse për shkelje të Kushtetutës vetëm për veprimet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Gjykata në secilin rast, sipas detyrës zyrtare dhe gjatë gjithë procedurës, do ta shqyrtojë përputhshmërinë *ratione temporis* të kërkesës me Kushtetutën.

Thënë këtë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka juridiksion *ratione temporis* (i) për të trajtuar shkeljet e vazhdueshme, të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe kanë vazhduar edhe pas hyrjes së saj në fuqi (shih, rastin e GJEDNJ-së [Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr.14556/89, Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 40); dhe (ii) për një rast që daton para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, nëse procedurat e zhvilluara pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, në vetvete dhe ndarazi nga veprimet paraprake, paraqesin shkelje të supozuara kushtetuese (shih, rastin e GJEDNJ-së [Kotov kundër Rusisë](#), nr. 54522/00, Aktgjykim i datës 3 prill 2012, paragrafët 68-69). Megjithatë, zhvillimi i procedurave gjyqësore pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, të cilat nuk e anuluan vendimin i cili përmban shkelje të supozuara kushtetuese, nuk e zgjeron juridiksionin e Gjykatës (shih, rastin e GJEDNJ-së [Blečić kundër Kroacisë](#), cituar më lartë, paragrafët 77-79 dhe 85).

Gjykata ka konstatuar se kërkesat individuale, përmes të cilave janë pretenduar shkeljet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, e që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën (shih, ndër tjerash rastet e Gjykatës [K1198/19](#), me parashtrues [Besnik Kavaja](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2020, paragrafët 36-37; [K1152/11](#), me parashtrues [Bekim Murati](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 qershorit 2012, paragrafi 23; [K166/11](#), me parashtrues [Astrit Shabani](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 marsit 2012, paragrafi 14; [K154/11](#), me parashtrues [Adem Qamili](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 nëntorit 2011, paragrafët 17-20; [K148/10](#), me parashtrues [Naser Rexhepi](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2010, paragrafi 22; [K128/11](#), me parashtrues [Ismet](#)

*Boshnjaku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 janarit 2012, paragrafi 13; dhe [KI34/10](#), me parashtrues *Bislim Kosumi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 janarit 2011, paragrafët 14-19). Ngjashëm, Gjykata ka trajtuar disa pretendime të parashtruesit përkatës ndaras, atëherë kur procedura të ndara janë zhvilluar para dhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, duke konstatuar që një nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhej me një procedurë të zhvilluar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ishte *ratione temporis* e papajtueshme me Kushtetutën, përderisa vazhdoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve përkitazi me procedura të tjera gjyqësore të zhvilluara pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës [KI62/19](#), me parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 13 nëntorit 2019, paragrafët 44-45, përmes të cilit Gjykata nuk e shpalli në tërësinë e saj si të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të papajtueshme *ratione temporis* me Kushtetutën).

Me rastin e përcaktimit të kohës së veprimit i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka parasysh vendimin përfundimtar i cili ka shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, Gjykata mund të marrë parasysh faktet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, për aq sa ato kanë krijuar një situatë që shtrihet edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës apo që mund të jenë të rëndësishme për të kuptuar faktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

## 4. PAPAJTUESHMËRIA RATIONE LOCI

### Rregulli 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (3) (e) i Rregullores së punës

[...]

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

[...]

(e) Kërkesa nuk është *ratione loci* në pajtim me Kushtetutën.

[...]

### 4.1 QËLLIMI/KUPTIMËSIA E PAPAJTUESHMËRISË RATIONE LOCI ME KUSHTETUTËN

Pajtueshmëria *ratione loci* e kërkesës me Kushtetutën, në parim, nënkupton që shkeljet e pretenduara kushtetuese duhet të jenë kryer brenda territorit të Republikës së Kosovës (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 84-90). Më saktësisht, kërkesat që përmbajnë pretendime për shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat janë kryer jashtë territorit të Republikës së Kosovës, konsiderohen nga Gjykata si të papranueshme për shkak të mungesës së pajtueshmërisë *ratione loci* me Kushtetutën.

Gjykata deri më tani në praktikën e saj gjyqësore, nuk ka pasur rast që të shqyrtojë kërkesa individuale e që ndërlidhen me papajtueshmërinë *ratione loci* me Kushtetutën. Thënë këtë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethana të rasteve që është e nevojshme, pajtueshmëria *ratione loci* në një kërkesë individuale, shqyrtohet nga Gjykata edhe nëse palët nuk kanë ngritur këtë pretendim (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Vasiliciuc kundër Republikës së Moldovës](#), nr.15944/11, Aktgjykim i 2 majit 2017, paragrafi 22).



# VIII. HEDHJA POSHTË DHE REFUZIMI I KËRKESËS

**R**regulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) i Rregullores së punës, përcakton rrethanat, kur Gjykata hedhë poshtë apo me procedurë të shkurtër refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të dorëzuar në Gjykatë në rastet kur: (i) pretendimi i parashtruesit të kërkesës nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm apo kërkesa nuk përfaqëson më kontest, sepse është zgjidhur; dhe (ii) kur kërkesa e parashtruar në Gjykatë, nuk është plotësuar me dokumentacionin dhe informatat e specifikuar sipas rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës.

## 1. RASTI NUK ËSHTË MË NË MËNYRË AKTIVE I DISKUTUESHËM

### Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) (1) (a) i Rregullores së punës

*(1) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur Gjykata përcakton se pretendimi:*

*(a) nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm.*

*[...]*

Në rast të ndryshimit të rrethanave që ndërlidhen me kërkesën pas parashtrimit të saj në Gjykatë dhe para se kjo e fundit të vendosë lidhur me rastin, Gjykata mund të vendosë që të mos vazhdojë me shqyrtimin e mëtejshëm të kriterëve të pranueshmërisë, ashtu siç përcaktohen me Kushtetutë, Ligj dhe rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës apo/edhe të shqyrtimit në merita të pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, kur konstatojnë që pretendimi i ngritur në kërkesë “nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm”.

Në rrethana të tilla, para se Gjykata të shqyrtojë plotësimin e kriterëve procedurale të kërkesës, e njëjta bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerëson (i) nëse qëndrojnë ende rrethanat për të cilat ish-in ankuar parashtruesit e kërkesës; dhe (ii) nëse efekti i shkeljes eventuale të Kushtetutës për shkak të atyre rrethanave është korrigjuar (shih, rastet e Gjykatës, [K1195/18](#), me parashtrues *Afrim Haxha*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 23 korrikut 2019, paragrafët 24-26; dhe [KO98/20](#), me parashtrues *Hajrulla Ceko dhe 29 deputetë të tjerë*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 52/2020, Vendim për heqje të rastit nga lista, i 18 nëntorit 2020, paragrafi 85; dhe rastet e GJEDNJ-së, [El Majjaoui & Stichtung Touba Moskee kundër Holandës](#), nr. 25525/03, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2007, paragrafi 30; [Pisano kundër Italisë](#), nr. 36732/97, Aktgjykim i 27 korrikut 2000, paragrafi 42; dhe [Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë](#), i cituar më lart, paragrafi 97).

Për shembull, Gjykata, në rastin K1195/18, kishte vendosur ta hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për faktin se para se Gjykata të vendoste në lidhje me kërkesën përkatëse, Gjykata Supreme kishte anuluar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit para kësaj Gjykate nuk është në fuqi dhe si i tillë, nuk prodhon asnjë efekt juridik për parashtruesin e kërkesës (paragrafët 14-26 të Vendimit në rastin K1195/18, të cituar më lart).

## 2. RASTI NUK PËRFAQËSON NJË KONTEST

### Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) (1) (b) i Rregullores së Punës

(1) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur Gjykata përcakton se pretendimi:

[...]

(b) nuk përfaqëson një kontest.

Në rrethanat kur çështja që ndërlidhet me objektin e vlerësimit të kërkesës nga Gjykata është zgjidhur, atëherë kjo e fundit vendosë që të hedhë poshtë kërkesën për shkak se kërkesa ka mbetur pa objekt shqyrtimi dhe e njëjta nuk përfaqëson më kontest apo rast para Gjykatës (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI91/20](#), me parashtrues *Qerim Berisha, Fadil Gashi, Tahir Morina, Selim Berisha, Naim Berisha, Burim Berisha, Z. B.*, Vendimi për hedhje të kërkesës, i 5 majit 2022, paragrafi 47; [KI155/15](#) dhe [KI157/15](#), me parashtruese *Snežana Zdravković dhe Milorotka Nikolić*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 17 majit, paragrafi 42-45; dhe [KI143/15](#), me parashtruese *Donika Kadaj-Bujupi*, Vendimi për hedhje poshtë të kërkesës, i 8 shkurtit 2016, paragrafët 36-37).

Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një rast në meritat e tij, para së gjithash, sigurohet nëse çështja që ngritet para saj paraqet një kontest specifik. Thënë ndryshe, Gjykata paraprakisht do të kontrollojë ekzistencën e një kontesti në mes të parashtruesit të kërkesës dhe autoritetit publik që ka nxjerrë aktin e kontestuar.

Rasti nuk përfaqëson një kontest nëse kërkesa e parashtruesit përkatës nuk konteston një akt specifik të një autoriteti publik. Për shembull, ankesat për moszbatim të përgjithshëm të ligjit, nuk paraqesin në vetvete një kontest, përderisa nuk atakohet një akt konkret i një autoriteti publik (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI97/23](#), me parashtruese *Gjevrije Zeqiri*, Vendim për hedhje të kërkesës, i 31 gushtit 2023, paragrafët 29-31).

Gjykata po ashtu ka konstatuar se nuk përfaqësojnë kontest rastet me pretendime për shkelje kushtetuese nga aktet e autoriteteve publike, nëse pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë adresuar me ndonjë akt të mëvonshëm (shih, rastet e Gjykatës [KI155/15](#) dhe [KI157/15](#), me parashtruese *Snežana Zdravković dhe Milorotka Nikolić*, i cituar më lart, paragrafi 42; [KI58/12](#), [KI66/12](#) dhe [KI94/12](#), me parashtrues *Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunale të KK të Vitisë*, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 5 korrikut 2013, paragrafi 45; dhe [KI06/13](#), me parashtrues *Sulejman Mustafa*, Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 16 tetorit 2013, paragrafi 37).

### 3. KËRKESA ËSHTË JO E PLOTË OSE E PAQARTË

#### Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) (2) (a) i Rregullores së punës

(2) Gjykata mund të vendose ta refuzojë një kërkesë me procedure të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit për Gjykatën Kushtetues përcakton detyrimin e parashtruesit të kërkesës që kërkesën e parashtruar para Gjykatës ta qartësojë saktësisht në kontekst të (i) aktit konkret të autoritetit publik të cilin e konteston; dhe (ii) të drejtave dhe lirive themelore që pretendon se i janë cenuar përmes aktit të kontestuar. Për më tepër, rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) i Rregullores së punës paraqet në mënyrë specifike dhe shteruese elementet të cilat duhet t'i përmbajë një kërkesë, në mënyrë që e njëjta të konsiderohet e kompletuar. E njëjta duhet të dorëzohet duke përdorur formularin zyrtar të kërkesës të publikuar në uebfaqen e Gjykatës ose ekuivalentin e saj dhe duhet të përfshijë (i) datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga pala që e parashtron; (ii) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (iii) emrin dhe adresën e përfaqësuesit/es për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (iv) autorizimin për përfaqësim; (v) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (vi) mbrojtjen juridike të kërkuar; (vii) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (viii) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (ix) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

Gjykata, përmes praktikës së vet gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën, bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI01/23](#), me parashtrues *Amir Hamza*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i datës 14 dhjetor 2023; [KI 60/20](#), me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; [KI90/20](#), me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe [KI78/20](#), [KI79/20](#) dhe [KI80/20](#), me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).

Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës se Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i shpallë këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e tyre, duke i refuzuar me procedurë të shkurtër (shih, ndër të tjerash, rastet e Gjykatës [KI 60/20](#), me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; [KI90/20](#), me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25 dhe [KI78/20](#), [KI79/20](#) dhe [KI80/20](#), me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).

Në këto raste, Gjykata ka konsideruar se kërkesat nuk i përmbushin kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ndër tjerash, në rastet kur: (i) parashtruesit e kërkesës nuk kanë specifikuar dhe dorëzuar aktin e autoritetit publik të cilin e kontestojnë ashtu siç kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës (shih, ndër tjerash, rastet [KI118/22](#), me parashtrues *Bekim Bajrami*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik,

Vendim për refuzim të kërkesës, i 4 prillit 2023, paragrafi 36; [KI13/23](#), me parashtruese *Marigona Djordjević-Jakaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 gushtit 2023; dhe [KI56/23](#), me parashtruese *Lendita Zherka*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik, Vendim për refuzim të kërkesës, i 31 gushtit 2023); (ii) në kërkesë specifikohet se parashtruesi/ja e kërkesës përfaqësohen me përfaqësues, por të njëjtit nuk kanë dorëzuar autorizim të vlefshëm për përfaqësim para Gjykatës (shih, ndër tjerash, rastin [KI 204/22](#), me parashtrues *Ismet Islami*, parashtrues i pretenduar i *Fatmir dhe Shpejtim Behramit*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 27 prillit 2023; dhe [KI02/20](#), me parashtrues *Skender Musa si përfaqësues i pretenduar i E.Z.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 prillit 2020); dhe (iii) parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kërkesën me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përkatësisht me aktet e ndryshme të autoriteteve publike, përkundër kërkesës së Gjykatës (shih, ndër tjerash, rastin [KI101/21](#), me parashtrues “*N. T. Sh. Morina B*”, Vendim për refuzim, i 8 shtatorit 2021).

## 4. RIPËRSËRITJA E KËRKESËS

### Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) (2) (b) i Rregullores së punës

(2) Gjykata mund të vendose ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

[...]

(b) kërkesa është ripërsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata.

Ankesa individuale në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiskioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si një mundësi për të kërkuar në mënyrë të ripërsëritur nga Gjykata që të rihapë vendimet e saj dhe të gjykojë sërish çështjen e njëjtë (shih, rastet e Gjykatës [KI105/16](#), me parashtrues *Feti Gashi*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i 4 prillit 2017, paragrafi 21; dhe [KI96/23](#), me parashtrues *Muhamet Miftari*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i datës 31 gusht 2023, paragrafi 35), sepse bazuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, “vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës” (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI26/14](#), me parashtrues *Bajrush Gashi*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 26 marsit 2015, paragrafët 26 dhe 27; [KI102/19](#), me parashtrues *Bedri Gashi*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i 7 nëntorit 2019, paragrafët 21 dhe 22; dhe [KI43/21](#), me parashtrues *N.T.P Arta Impex*, Vendim për Refuzim, i 5 majit 2021, paragrafi 23).

Në vijim të kësaj, Gjykata ka vlerësuar se në rast se parashtruesi i kërkesës ngritë të njëjtat pretendime dhe paraqet të njëjtat fakte dhe dëshmi si në kërkesën e mëparshme të vendosur nga Gjykata, kjo e fundit refuzon kërkesën me procedurë të shkurtër (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI43/21](#), me parashtrues *N.T.P Arta Impex*, cituar më lart, paragrafët 25-26).

Bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GEJDNJ-së, Gjykata thekson se e vetmja mënyrë që ajo të shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me faktet e njëjta si në kërkesën e mëparshme, është që parashtruesi i kërkesës duhet vërtetë të ofrojë informacione të reja të cilat më parë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI96/23](#), me parashtrues *Muhamet Miftari*, cituar më lart, paragrafi 35; dhe shih, po ashtu rastin e GEJDNJ-së, *Kafkaris kundër Qipros*, nr. [9644/09](#), Vendimi për pranueshmëri, i 21 qershorit 2011, paragrafi 68).

## 5. KEQPËRDORIMI I TË DREJTËS NË PETICION

### Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) (2) (c) i Rregullores së punës

(2) Gjykata mund të vendos ta refuzojë një kërkesë me procedure të shkurtër në qoftë se:

[...]

(c) parashtruesi/ja ka keqpërdorur të drejtën në peticion.

E drejta në peticion, përkatësisht e drejta për të iniciuar kërkesa pranë Gjykatës, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiskioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nuk mund të keqpërdoret. Përkatësisht, kjo e drejtë nuk mund të përdoret jashtë funksionimit të asaj për çfarë është garantuar.

Më saktësisht dhe sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, si “keqpërdorim” i të drejtës në peticion sipas paragrafit 3 të nenit 35 (Kushtet e pranueshmërisë) të KEDNJ-së, janë konsideruar rastet në të cilat: (i) parashtruesi me vetëdije është bazuar në fakte të pavërteta (shih, rastin të GJEDNJ-së [Gross kundër Zvicrës](#), nr. 67810/10, Aktgjykim, i 30 shtatorit 2014, paragrafët 28 dhe 37); (ii) parashtruesi i kërkesës përdorë gjuhë të papërshtatshme (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Zhdanov dhe të tjerët kundër Rusisë](#), nr.12200/08, Aktgjykim, i 16 korrikut 2019 paragrafët 79-81); (iii) parashtruesi i kërkesës nuk e njofton Gjykatën për faktet thelbësore, qoftë kjo në momentin e parashtrimit të kërkesës apo edhe në rastet kur gjatë zhvillimit të procedurës paraqiten fakte të rëndësishme (shih, rastin e GJEDNJ-së [Avag GEVORGYAN dhe të tjerët kundër Armenisë](#), nr. 66535/10, Aktvendim, i 14 janarit 2020, paragrafët 31-37); (iv) mashtrimi i Gjykatës bëhet nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Bekauri kundër Gjeorgjisë](#), nr. 14102/02, Aktgjykim, i 10 prillit 2012, paragrafët 21-25; dhe (v) parashtruesi i kërkesës në mënyrë të ripërsëritur paraqet kërkesa të pabazuara, duke shfaqur një sjellje dukshëm abuzive, e cila e ngarkon pa nevojë Gjykatën (shih, rastet e GJEDNJ-së, [G. & D.M. kundër Bullisë Bashkuar](#), nr. 13284/87, Vendim, i 15 tetorit 1987; [Nicholas Philis kundër Greqisë](#), nr. 28970/95, Vendim, i 17 tetorit 1996; dhe [Bekauri kundër Gjeorgjisë](#), cituar më lart, paragrafi 21).

Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, Gjykata, në rastet [KI228/13](#), [KI04/14](#), [KI11/14](#), [KI13/14](#), me parashtrues [Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 marsit 2014, ka konstatuar keqpërdorim të së drejtës në peticion, ashtu siç përcaktohet me Rregulloren e punës, për shkak se parashtruesit e kërkesës (i) në mënyrë të vazhdueshme kishin parashtruar kërkesa në lidhje me çështje identike të objektit, për të cilat Gjykata tashmë kishte vendosur; dhe (ii) në kërkesat e tanishme, të njëjtit kishin dorëzuar “kërkesa të pabazuara, të ripërsëritura, abuzive dhe të bezdisshme duke penguar punën e Gjykatës dhe duke i marrë kohën dhe mjetet e saj.” (shih, paragrafët 59-60 të këtij Aktvendimi).

# LISTA E RASTEVE TË CITUARA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

- **KI208/23**, me parashtrues *Telekomi i Kosovës Sh.A*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 31 janarit 2024
- **KI134/23**, me parashtruese *Feride Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 17 janarit 2024
- **KI97/23**, me parashtruese *Gjevrije Zeqiri*, Vendim për hedhje të kërkesës, i 31 gushtit 2023
- **KI96/23**, me parashtrues *Muhamet Miftari*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i 31 gushtit 2023
- **KI61/23**, me parashtruese *Hedie Bylykbashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 majit 2023
- **KI57/23**, me parashtrues *Ismet Ferati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gushtit 2023
- **KI56/23**, me parashtruese *Lendita Zherka*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik, Vendim për refuzim të kërkesës, i 31 gushtit 2023
- **KI34/23**, me parashtrues *Veton Sylja*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023
- **KI26/23**, me parashtrues *Kastrioti Petrol*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 nëntorit 2023
- **KI25/23**, me parashtrues *Shpejtim Ahmeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 majit 2023
- **KI24/23**, me parashtrues *Sami Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 prillit 2023
- **KI13/23**, me parashtruese *Marigona Djordjević-Jakaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 gushtit 2023
- **KI07/23**, me parashtrues *Musli Morina*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2023
- **KI204/22**, me parashtrues *Ismet Islami*, parashtrues i pretenduar i *Fatmir dhe Shpejtim Behramit*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 27 prillit 2023
- **KI193/22**, me parashtrues *Avni Selmani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gushtit 2023
- **KI 144/22**, me parashtruese *Sebahate Dërvishi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 shtatorit 2022
- **KI143/22**, me parashtrues *Hidroenergji SHPK*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022
- **KI140/22**, me parashtrues *Imer Mustafa dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2022
- **KI126/22**, me parashtrues *Gëzim Bajrami*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2023
- **KI118/22**, me parashtrues *Bekim Bajrami*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik, Vendim për refuzim të kërkesës, i 4 prillit 2023
- **KI111/22**, me parashtrues *Bechtel Enka G.P.O.P*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2023
- **KI96/22**, me parashtrues *Naser dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023
- **KI89/22**, me parashtrues *Xhelal Plakolli*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 marsit 2023
- **KI57/22** dhe **KI79/22**, me parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktgjykim i 4 korrikut 2022
- **KI71/22**, me parashtrues *Muhamet Mehmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 14 nëntorit 2023
- **KI49/22**, me parashtrues *Zejnel Ninaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 gusht 2023
- **KI44/22**, me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri
- **KI31/22**, me parashtrues *Fidan Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 janarit 2023
- **KI10/22**, me parashtrues *Sindikata e Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022



- **KI03/22**, me parashtrues *EPS Trgovina* (Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022
- **KI234/21**, me parashtrues *N.P.N Çlirimi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 qershorit 2022
- **KI219/21**, me parashtrues *Isuf Ferati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2022
- **KI216/21**, me parashtrues *Kujtim Reznici*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2022
- **KI214/21**, me parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022
- **KI203/21** dhe **KI205/21**, me parashtrues *Nexhmije dhe Sahit Kabashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 9 marsit 2022
- **KI202/21**, me parashtrues *Kelkos Energy SH.P.K.*, Aktgjykim, i 29 shtatorit 2022
- **KI188/21**, me parashtrues *Zenel dhe Isuf Pllashniku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2022
- **KI186/21**, me parashtrues *Faik Miftari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 dhjetorit 2021
- **KI185/21**, me parashtrues *SHPK "CO COLINA"*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2023
- **KI183/21**, me parashtrues *Ejup Koci* (Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 marsit 2022
- **KO173/21**, me parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022
- **KI170/21, Arianit Sllamniku dhe të tjerët**, Aktvendim i 10 dhjetorit 2021
- **KO145/21**, me parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Aktgjykim i 10 marsit 2022
- **KI129/21**, me parashtruese *Velderda Sopi*, Aktgjykim i 7 marsit 2023
- **KI119/21**, me parashtrues *Ahmet Hoti dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 qershorit 2022
- **KI111/21**, me parashtrues *Shaban Murati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 prillit 2023
- **KI107/21**, me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021
- **KI101/21**, me parashtrues *"N. T.Sh. Morina B"*, Vendim për refuzim, i 8 shtatorit 2021
- **KI82/21**, me parashtrues *Komuna e Gjakovës*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2021
- **KI76/21**, me parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi, i 10 nëntorit 2021
- **KI75/21**, me parashtrues *"Abrazen LLC", "Energy Development Group Kosova LLC", "Alsi & Co. Kosovë LLC"* dhe *"Building Construction LLC"*, Aktgjykim i 19 janarit 2022
- **KI74/21**, me parashtrues *Halim Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 tetorit 2022
- **KI73/21**, me parashtruese *Minire Krasniqi-Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2021
- **KI70/21**, me parashtrues *Burhan Tusha*, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 qershorit 2021
- **KI63/21**, me parashtrues *Hysen Metahysa*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 tetorit 2021
- **KI59/21**, me parashtrues *Partia Demokratike e Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2021
- **KI48/21**, me parashtrues *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 qershorit 2021
- **KI45/21**, me parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021
- **KI43/21**, me parashtrues *N.T.P Arta Impex*, Vendim për Refuzim, i 5 majit 2021
- **KI35/21**, me parashtrues *Sulejman Mushoviq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 korrikut 2021
- **KI32/21**, me parashtrues *Hasan Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 qershorit 2021
- **KI25/21**, me parashtrues *Ymer Koro, si përfaqësues i pretenduar i K.Lj. dhe K.B.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 21 korrikut 2021
- **KI21/21**, me parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021
- **KI15/21**, me parashtrues *Bersim Sulja*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 korrikut 2021

- **KI08/21**, me parashtruese *Mirishahe Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 qershorit 2021
- **KI195/20**, me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021
- **KI193/20**, me parashtrues *Bujar Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 majit 2021
- **KI182/20**, me parashtrues *Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi*, Aktgjykim i 20 janarit 2022
- **KI179/20**, me parashtrues *Telekom i Kosovës Sh.A*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 janarit 2021
- **KI175/20**, me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021
- **KI174/20**, me parashtrues *DE-KO Sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021
- **KI164/20**, me parashtrues *Rafet Haxhaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021
- **KI161/20**, me parashtrues *Bedri Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shtatorit 2021
- **KI160/20**, me parashtrues *Komuna e Gjilanit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 majit 2022
- **KI147/20, KI148/20, KI149/20, KI150/20, KI151/20 dhe KI152/20**, me parashtrues *Nezir Neziri dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021
- **KI137/20**, me parashtrues *Ali Latifi, si përfaqësues i pretenduar i M.S.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 nëntorit 2020
- **KI124/20** me parashtrues *Muhamed Ali Ceysülmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021
- **KI118/20** me parashtrues *Selim Leka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021
- **KI115/20**, me parashtrues *Muharrem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, 3 nëntorit 2021
- **KO98/20**, me parashtrues *Hajrulla Ceko dhe 29 deputetë të tjerë*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 52/2020, Vendim për heqje të rastit nga lista, i 18 nëntorit 2020
- **KI97/20**, me parashtrues *Nehat Salihu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 marsit 2021
- **KI91/20**, me parashtrues *Qerim Berisha, Fadil Gashi, Tahir Morina, Selim Berisha, Naim Berisha, Burim Berisha, Z. B.*, Vendimi për hedhje të kërkesës, i 5 majit 2022
- **KI90/20**, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020
- **KI88/20**, me parashtrues *Klubi i Futbollit "Liria"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 shtatorit 2020
- **KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20**, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020
- **KI77/20**, me parashtrues *Kujtim Zarari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020
- **KI 60/20**, me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021
- **KI40/20**, me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021
- **KI39/20**, me parashtrues *Cihan Ozkan*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021
- **KI27/20**, me parashtrues *Lëvizja Vetëvendosje!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020
- **KI11/20**, me parashtruese *Fllanza Pozhegu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020
- **KI02/20**, me parashtrues *Skender Musa si përfaqësues i pretenduar i E.Z.*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 prillit 2020
- **KI230/19**, me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020
- **KI229/19**, me parashtrues *Organizata Joqeveritare "Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim AKEA"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021
- **KI218/19**, me parashtrues *Shani Morina*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020

- **KI211/19**, me parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., HZ., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I. dhe S.R.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020
- **KI207/19**, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020
- **KI206/19**, me parashtrues *Mladen Nikolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shkurtit 2020
- **KI198/19**, me parashtrues *Besnik Kavaja*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2020
- **KI175/19**, me parashtrues *Ismajl Zogaj*, Aktgjykim i 1 korrikut 2021
- **KI143/19**, me parashtrues *Agim Thaqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2020
- **KI137/19**, me parashtrues *Arlind Morina*, Aktvendim për Papranueshmëri i 2 shtatorit 2020
- **KI136/19**, me parashtrues *SHPK "CO COLINA"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021
- **KI123/19**, me parashtrues *"SUVA Rechtsabteilung"*, Aktgjykim i 13 majit 2020
- **KI107/19**, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020
- **KI102/19**, me parashtrues *Bedri Gashi*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i 7 nëntorit 2019
- **KI95/19**, me parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019
- **KI81/19**, me parashtrues *Skënder Podrimqaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 nëntorit 2019
- **KI62/19**, me parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 13 nëntorit 2019
- **KI49/19**, me parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SHA, "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019
- **KI37/19**, me parashtrues *Federata e Taekëondo e Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 dhjetorit 2019
- **KI30/19**, me parashtrues *Isni Kryeziu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2019
- **KI09/19**, me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020
- **KI195/18**, me parashtrues *Afrim Haxha*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 23 korrikut 2019
- **KI179/18**, me parashtruese *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020
- **KI174/18**, me parashtrues *Bedri Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 prillit 2019
- **KI163/18**, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020
- **KI161/18**, me parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 qershorit 2019
- **KI155/18**, me parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019
- **KI149/18, KI150/18, KI151/18, KI152/18, KI153/18**, me parashtrues *Xhavit Aliu dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 korrikut 2019
- **KI147/18**, me parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 shtatorit 2019
- **KI126/18**, me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 shkurtit 2020
- **KI108/18**, me parashtruese *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shtatorit 2019
- **KI90/18**, me parashtrues *Nedvedete Ponosheci dhe Atdhe Ponosheci*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15 janarit 2020
- **KI76/18**, me parashtrues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018
- **KI71/18**, me parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018

- **KI67/18**, me parashtruese *Arbenita Arifi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 14 majit 2019
  - **KI50/18**, me parashtrues *Deljalj Kazagić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019
  - **KI59/18**, me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 mars 2019
  - **KI56/18**, me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020
  - **KI53/18**, me parashtrues *Hajri Ramadani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 nëntorit 2018
  - **KI52/18**, me parashtrues *Zoran Stanišić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019
  - **KI42/18**, me parashtruese *Asija Muslija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020
  - **KI41/18**, me parashtruese *Gordana Dončić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 26 shtatorit 2018
  - **KI35/18**, me parashtrues *“Bayerische Versicherungsverband”*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019
  - **KI31/18**, me parashtrues *Komuna e Pejës*, Aktgjykim i 12 prillit 2019
  - **KI06/18**, me parashtrues *Shkumbin Mehmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019
  - **KI05/18 dhe KI154/17** dhe, me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”* Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019
- KI02/18**, me parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019
- **KI154/17 dhe KI05/18**, me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”* Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019
  - **KI133/17**, me parashtrues *Ali Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 korrikut 2019
  - **KI 122/17**, me parashtrues *Česká Exportni Banka A.S.*, Aktgjykim i 18 prillit 2018
  - **KI120/17**, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017
  - **KI119/17**, me parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2019
  - **KI110/17**, me parashtrues *Sekule Stanković*, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 24 majit 2018
  - **KI91/17**, me parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018
  - **KI75/17**, me parashtrues *X*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017
  - **KI55/17**, me parashtruese *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017
  - **KI34/17**, me parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017
  - **KI30/17**, me parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 korrikut 2017
  - **KI07/17**, me parashtrues *Pashk Mirashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 majit 2017
  - **KI04/17**, me parashtrues *Z. K.*, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 2 qershorit 2017
  - **KI150/16** me parashtrues, *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018
  - **KI149/16**, me parashtrues *Komuna e Klinës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 tetorit 2017
  - **KI 123/16**, me parashtrues *Vullnet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 korrikut 2017
  - **KI122/16** me parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykimi, i 30 majit 2018
  - **KI108/16**, me parashtrues *Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016
  - **KI105/16**, me parashtrues *Feti Gashi*, Vendimi për refuzim të kërkesës, i 4 prillit 2017
  - **KI102/16**, me parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 dhjetor 2016
  - **KI90/16**, me parashtrues *Branislav Jokić*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2017

- **KI57/16**, me parashtrues *Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 korrikut 2017
- **KI24/16**, me parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15 shtatorit 2016
- **KI15/16**, me parashtrues *Ramadan Muja*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016
- **KI155/15 dhe KI157/15**, me parashtruese *Snežana Zdravković dhe Milorotka Nikolić*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 17 majit 2016
- **KI143/15**, me parashtruese *Donika Kadaj-Bujupi*, Vendimi për hedhje poshtë të kërkesës, i 8 shkurtit 2016
- **KI89/15**, me parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 janarit 2015
- **KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15**, me parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016
- **KI 65/15**, me parashtrues *Tatjana Davila, Ljubića Maric, Zorica Krsenković, Zlatoj Jevtić*, Aktgjykim i 14 shtatorit 2016
- **KI63/15**, me parashtrues *Bedri Haxhi Halili*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2015
- **KI20/15**, me parashtrues *Organizata Joqeveritare FINCA - Kosovë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 31 korrikut 2015
- **KI15/15**, me parashtrues *Hysni Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 korrikut 2015
- **KI185/14**, me parashtrues *Zoran Kolić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 8 korrikut 2015
- **KI168/14**, me parashtrues *Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 gushtit 2015
- **KI138/14**, me parashtrues *Majda Fazli-Neziri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2014
- **KI99/14 dhe KI100/14**, me parashtrues *Shyqri Sylja dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 3 korrikut 2014
- **KI26/14**, me parashtrues *Bajrush Gashi*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 26 marsit 2015
- **KI04/14, KI11/14, KI13/14, KI228/13**, me parashtrues *Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 marsit 2014
- **KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14**, me parashtrues *Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 marsit 2014
- **KI 53/11, KI 25/12, KI 100/12 dhe KI 49/13**, me parashtrues *Isa Grajqevci, Fehmi Ajvazi, Musli Nuhui dhe Ramadan Imeri*, Aktgjykim i 14 tetorit 2013
- **KI06/13**, me parashtrues *Sulejman Mustafa*, Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 16 tetorit 2013
- **KI139/12**, me parashtrues *Besnik Asllani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 janarit 2013
- **KI115/12**, me parashtrues *Fadil Salihu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2013
- **KI84/12**, me parashtrues *Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012
- **KI58/12, KI66/12 dhe KI94/12**, me parashtrues *Selatin Gashi, Halit Azemi dhe grupi i këshilltarëve komunal të KK të Vitisë*, Vendim për Heqje nga Lista e Kërkesës, i 5 korrikut 2013
- **KI 53/11, KI 25/12, KI 100/12 dhe KI 49/13**, me parashtrues *Isa Grajqevci, Fehmi Ajvazi, Musli Nuhui dhe Ramadan Imeri*, Aktgjykim i 14 tetorit 2013
- **KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12 dhe KI 14/12**, me parashtrues *Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, Aktgjykim i 26 shtatorit 2012



- **KI41/12**, me parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2013
- **KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12 dhe KI 14/12**, me parashtrues Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Aktgjykim i 26 shtatorit 2012
- **KI152/11**, me parashtrues *Bekim Murati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 qershorit 2012
- **KI149/11**, me parashtrues *Shefqet Aliu*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2012
- **KI139/11**, me parashtrues *Ali Latifi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 marsit 2012
- **KI 138/11**, me parashtruese *Nazife Xhafolli*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2014
- **KI117/11**, me parashtrues *Ridvan Hoxha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 korrikut 2012
- **KI66/11**, me parashtrues *Astrit Shabani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 marsit 2012
- **KI54/11**, me parashtrues *Adem Qamili*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 nëntorit 2011
- **KI 53/11, KI 25/12, KI 100/12 dhe KI 49/13**, me parashtrues, *Isa Grajqevci, Fehmi Ajvazi, Musli Nuhiu dhe Ramadan Imeri*, (Aktgjykim i 14 tetorit 2013
- **KI28/11**, me parashtrues *Ismet Boshnjaku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 janarit 2012
- **KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12 dhe KI 14/12**, me parashtrues Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Aktgjykim i 26 shtatorit 2012
- **KI118/10**, me parashtrues *Shoqata e Sigurimeve të Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 23 majit 2011
- **KI114/10**, me parashtruese *Vahide Badivuku*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 qershorit 2011
- **KI25/10**, me parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktgjykim i 30 marsit 2011
- **KI06/10**, me parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010
- **KI63/09**, me parashtrues *Bajram Santuri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 korrikut 2011
- **KI56/09**, me parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010
- **KI29/09, KI32/09 dhe KI47/09**, me parashtrues *Teki Bokshi, Avdi Rizvanolli and Qaush Smajlaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2010
- **KI43/09**, me parashtrues **Lëvizja FOL**, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 majit 2011
- **KI40/09**, me parashtrues *Imer Ibrahimimi dhe 48 Ish-Punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, Aktgjykim i 16 qershorit 2010
- **KI11/09**, me parashtrues *Tomë Krasniqi*, Vendim për Heqje nga Lista e Kërkesës, i 17 majit 2011



# LISTA E RASTEVE TË CITUARA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

---

## -A-

*Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 14807/89, Aktgjykimi i 24 tetorit 1995  
*Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21893/93, Aktgjykimi i 1 prillit 1998  
*Alberti dhe të tjerët kundër Hungarisë*, nr.5294/14, Aktgjykimi i 7 korrikut 2020  
*Ananyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 42525/07 dhe 60800/08, Aktgjykimi i 10 janarit 2012  
*Aquilina kundër Maltës*, nr. 25642/94, Aktgjykimi i 29 prillit 1999  
*Avag GEVORGYAN dhe të tjerët kundër Armenisë*, nr. 66535/10, Aktvendim, i 14 janarit 2020  
*Aydarov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 33586/15, Vendim i 2 tetorit 2018

---

## -B-

*Bekauri kundër Gjeorgjisë*, nr. 14102/02, Aktgjykimi i 10 prillit 2012  
*Blečić kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, Aktgjykimi i 8 marsit 2006  
*Bochan kundër Ukrainës* (nr.2), nr. 22251/08, Aktgjykimi, i 5 shkurtit 2015

---

## -C-

*Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë*, nr. 38433/09, Aktgjykimi i 7 qershorit 2012  
*Civet kundër Francës*, nr. 29340/95, Aktgjykimi i 28 shtatorit 1999  
*Çelik kundër Turqisë*, nr. 52991/99, Vendim i 23 shtatorit 2004

---

## -D-

*D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 57325/00, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007  
*De Tommaso kundër Italisë* [DHM], nr. 43395/09, Aktgjykimi i 23 shkurtit 2017  
*Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 76573/01, Vendim për pranueshmëri, i 2 korrikut 2002  
*Demir dhe Baykara kundër Turqisë*, nr.34503/97, Aktgjykimi i 12 nëntorit 2018  
*Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04, 21819/04, Vendim i 10 marsit 2010  
*Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës*, nr.12747/87, Aktgjykimi i 26 qershorit 1992.

---

## -E-

*El Majjaoui & Stichtung Touba Moskee kundër Holandës*, nr. 25525/03, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2007

---

## -G-

*G. & D.M. kundër Bull së Bashkuar*, nr. 13284/87, Vendim i 15 tetorit 1987

*Gäfgen kundër Gjermanisë*, nr. 22978/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2010

*Galev dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr.18324/04, Vendim për Pranueshmëri, i 29 shtatorit 2009

*Gough kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 49327/11, Aktgjykim i 28 tetorit 2014

*Gross kundër Zvicrës (Nr. 2)*, nr.12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009

*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr. 62543/00, Vendim i 27 prillit 2004

*Gross kundër Zvicrës*, nr. 67810/10, Aktgjykim i 30 shtatorit 2014

*Hartung kundër Francës*, nr. 10232/07, Vendim për Pranueshmëri, i 3 nëntorit 2009

---

## -H-

*Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldovës dhe Ruisë*, nr.48787/99, Aktgjykim i 8 korrikut 2004

---

## -J-

*Jeličić kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, nr. 41183/02, Vendim mbi Pranueshmërinë, i 15 nëntorit 2005

---

## -K-

*Kafkaris kundër Qipros*, nr. 9644/09, Vendim për pranueshmëri, i 21 qershorit 2011

*Karakó kundër Hungarisë*, nr. 39311/05, Aktgjykim i 28 prillit 2009

*Karapanagiotou dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 1571/08, Aktgjykim i 28 tetorit 2010

*Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, Aktgjykim i 6 majit 2003

*Kononov kundër Letonisë [DHM]*, nr. 36376/04, Aktgjykim, i 17 majit 2010

*Kotov kundër Ruisë*, nr. 54522/00, Aktgjykim i 3 prillit 2012

*Kudić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, nr. 28971/05, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2008

---

## -L-

*Lekić kundër Sllovenisë*, nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018

*Lepojić kundër Serbisë*, nr. 13909/05, Aktgjykim i 6 nëntorit 2007

*Loizidou kundër Turqisë*, nr.15318/89, Aktgjykim i 23 marsit 1995

---

## -M-

*M.A. dhe të tjerët kundër Lituanisë*, nr.59793/17, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018  
*M.N. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr.3599/18, Aktgjykim i 5 marsit 2020  
*Margulev kundër Ruisë*, nr. 15449/09, Aktgjykimi i 8 tetorit 2019  
*Melnichuk dhe të tjerët kundër Rumanisë* (nr.35279/10 dhe 34782/10, Aktgjykim i 5 majit 2015  
*Mentzen kundër Letonisë*, nr. 71074/01, Vendim për Pranueshmëri, i 7 dhjetorit 2004  
*Micallef kundër Maltës* (nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009  
*Mocanu dhe Të Tjerët kundër Rumanisë*, nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim, i 17 shtatorit 2014  
*Molla Sali kundër Greqisë*, nr. 20452/14, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018  
*Moreira Barbosa kundër Portugalisë*, nr.65681/01, Vendim i 29 prillit 2004  
*Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr.2), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017  
*Mykhaylenky dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr.35091/02, 35196/02, 35201/02, 35204/02, 35945/02,35949/02, 35953/02, 36800/02, 38296/02, dhe 42814/02, Aktgjykim i 30 nëntorit 2004

---

## -N-

*N.D. dhe N.T. kundër Spanjës*, nr. 8675/15 dhe 8697/15  
*Nencheva dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr.48609/06, Aktgjykim i 18 qershorit 2013  
*Nicholas Philis kundër Greqisë*, nr. 28970/95, Vendim, i 17 tetorit 1996

---

## -O-

*Öcalan kundër Turqisë*, nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005  
*Opuz kundër Turqisë*, nr. 33401/02, Aktgjykim i 9 qershorit 2009

---

## -P-

*Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr.14556/89, Aktgjykim i 24 qershorit 1993  
*Paposhvili kundër Belgjikës*, nr.41738/10, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016  
*Pisano kundër Italisë*, nr. 36732/97, Aktgjykim i 27 korrikut 2000

---

## -Q-

*Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë*, nr.47848/08, Aktgjykim i 17 korrikut 2014

---

## -R-

*Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 37685/10 dhe 22768/12, Aktgjykim, i 20 marsit 2018  
*Ringeisen kundër Austrisë*, nr. 2614/65, Aktgjykim i 16 korrikut 1971  
*Roland Klausecker kundër Gjermanisë*, nr. 415/07, Vendim i 6 janarit 2015

---

## -S-

*Sakvarelidze kundër Gjeorgjisë*, nr. 40394/10, Aktgjykim i 6 shkurtit 2020  
*Scordino kundër Italisë*, nr.36813/97, Aktgjykim i 29 marsit 2006  
*Scozzari dhe Giunta kundër Italisë*, nr. 39221/98 41963/98, Vendim i 15 shtatorit 1998  
*Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Herzegovinës*, nr.27996/06 dhe 34836/06, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009  
*Senator Lines GmbH, kundër 15 shteteve të Bashkimit Evropian*, nr. 56672/00, Vendim i 10 marsit 2004  
*Siliadin kundër Francës*, nr. 73316/01, Aktgjykim i 26 korrikut 2005  
*Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 korrikut 1989  
*Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë* [DHM], nr. 60654/00, Aktgjykim i 15 janarit 2007

---

## -Sh-

*Shishanov kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 11353/06, Aktgjykim i 15 Shtatorit 2015  
*Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Rumani – Komiteti i Helsinkit në Emër të Ionel Garcea kundër Rumanisë*, nr.2959/11, Aktgjykimi i 24 marsit 2015

---

## -T-

*Tokel kundër Turqisë*, nr.23662/08, Aktgjykim i 9 shkurtit 2021  
*Trajce Stojanovski kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 1431/03, Aktgjykim i 22 tetorit 2009

---

## -V-

*Van Oosterëijck kundër Belgjikës*, nr. 7654/76, Aktgjykim i 6 nëntorit 1980  
*Varanva dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe 9 të tjera, Aktgjykim i 18 shtatorit 2009  
*Vasiliciuc kundër Republikës së Moldovës*, nr.15944/11, Aktgjykim i 2 majit 2017  
*Velev kundër Bullgarisë*, nr. 43531/08, Aktgjykim i 16 prillit 2013  
*Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* [DHM] nr. 17153/11 dhe 21 kërkesa të tjera, Aktgjykim i 25 marsit 2014

---

## -Z-

*Zehentner kundër Austrisë*, nr.20082/02, Aktgjykim i 16 korrikut 2009  
*Zhdanov dhe të tjerët kundër Rusisë* nr.12200/08, Aktgjykim i 16 korrikut 2019.

---



